

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6010
E mërkurë, 26 shkurt 2020
çmimi 0.40 €

Veliu: Policia e Kosovës ende ka para vetes sfida të mëdha



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

A PO RREZIKOHET EDHE KOSOVA NGA KORONAVIRUSI?



Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) ka njoftuar të martën se në Klinikën Infektive janë paraqitur tri raste të dyshuara për koronavirus. Të tri rastet e dyshuara me koronavirus kanë ardhur nga Italia. Klinika Infektive ka theksuar se nuk ka nevojë për panik dhe

shqetësim meqë janë vetëm raste të dyshuara. Të tre të dyshuarve u janë marrë mostrat për analizë dhe janë dërguar në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike për verifikim. Ministria e Arsimit ka kërkuar nga drejtoritë komunale të arsimit dhe shkollat masa të shtuara

parandaluese rreth koronavirusit, ndërkaq në lidhje me këtë virus Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSShK) ka kërkuar nga ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, që të dihet se cilat janë kapacitetet e punëtorëve shëndetësorë për mbrojtjen e kësaj pandemie

Njohësit e integrimeve: Ende duhet të punohet për liberalizim të vizave

Njohësit e integrimeve evropiane kanë bërë me dije se liberalizimi i vizave për Kosovën varet nga faktorë të jashtëm dhe të brendshëm. Demush Shasha dhe Avni Mazrreku kanë deklaruar për "Epokën e re" se mosluftimi i korrupsionit dhe krimin të organizuar, mungesa e vullnetit të disa vende të BE-së dhe

ngecjet në procesin e dialogut Kosovë - Serbi janë faktorët kryesorë që po i mbajnë të izoluar qytetarët e Kosovës. Sipas tyre, nëse adresohen këto çështje nga institucionet e Kosovës mund të shpresohet për një vendimmarrje pozitive gjatë vitit 2020 për liberalizimin e vizave



OPINION

AKTAKUZAT E PARA NË GJYKATËN SPECIALE TANIMË JANË NGRITUR!

F. 7

Tomë GASHI



BASHKËPUNIMI SHQIPËRI - KOSOVË NË ARSIM DHE SHKENCË ËSHTË DOMOSDOSHMËRI PËR INTEGRIMIN NDËRSHQIPTAR

F. 11

Nga prof. dr. Myqerem TAJFAJ



AKTUALE



ANKETA: GJYKATAT PO SHËNOJNË NJË TREND POZITIV NË PËRMIRËSIMIN E PUNËS SË TYRE

F. 3

OSMANI: NJOHJA E PAVARËSISË NGA VATIKANI, NJOHJE E SAKRIFICËS SË POPULLIT TË KOSOVËS

F. 7

EKONOMI

KEK-u NË TRE VJETËT E ARDHSHËM PARASHEH INVESTIME 437 MILIONË EURO

F. 8

SPORT

MË 2 MARS DALIN NË SHITJE ONLINE BILETAT PËR NDESHJEN MAQEDONI E VERIUT - KOSOVË

F. 16

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

BE-ja ia vazhdon mandatin Natalya Apostolovës

PRISHTINË, 25 SHKURT - Këshilli i Bashkimit Evropian ka marrë vendim për zgjatjen e mandatit për gjashtë përfaqësuesit e tyre specialë që puno-

jnë në vende të ndryshme. Në mesin e këtyre gjashtë përfaqësuesve që iu është zgjatur mandati është edhe shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë,

Natalya Apostolova. Në vendimin e Këshillit Evropian është thënë se Apostolovës do t'i zgjatet mandati edhe për gjashtë

muaj të tjerë deri më 31 gusht 2020. Emërimi i Apostolovës si përfaqësueses e Zyrës së BE-së në Kosovë ishte bërë në gusht të vitit 2016.



Anketa: Gjykatat po shënojnë një trend pozitiv në përmirësimin e punës së tyre

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 SHKURT - Demokraci Plus (D+) dhe Qendra për Avokim dhe Kulturë Demokratike (ACDC), me mbështetjen e Programit të USAID për Fuqizim të Sistemit të Drejtësisë (USAID/JSSP), kanë mbajtur tryezë në të cilën janë paraqitur rezultatet e anketës me përdoruesit e shërbimeve të gjykatave themelore. Kjo anketë ka mbledhur të dhëna mbi përvojat e qytetarëve dhe avokatëve me shërbimet që kanë të bëjnë me qasjen në informata, efikasitetin, gjuhën e përdorur dhe shkallën e korrupsionit.

Christina Davis, drejtoreshë e DGO, USAID Kosovë, ka pohuar se rezultatet e këtyre anketave për shërbimet e gjykatave tregojnë se gjykatat janë vazhdimisht duke bërë përpjekje për t'i përmirësuar shërbimet e tyre për t'u ofruar qytetarëve drejtësi me kohë. Sipas

saj, problem i dukshëm mbetet dallimi në mes të perceptimit të përgjithshëm të qytetarëve dhe përvojës së shfrytëzuesve të gjykatave. "Siç e dimë, gurthemel i sundimit të ligjit është besimi i publikut në gjykata, por ky besim duhet të fitohet dhe të kultivohet. Gjykatat jo vetëm se duhet të jenë të drejta dhe të hapura, por duhet të perceptohen se janë të drejta. Shumë nga lajmet që dëgjojmë qoftë në lajme, qoftë nëpër kafene, nuk janë gjithmonë pozitive dhe njerëzit flasin për vendime të padrejta, sepse si njerëz jemi të prirë t'u kushtojmë vëmendje lajmeve negative. Madje kjo shpjegohet edhe nga studimet psikologjike. Megjithatë, rezultatet e anketës për shërbimet e gjykatave do të hedhin dritë mbi hendekun e madh mbi perceptimin e publikut mbi gjykatat në Kosovë. Pra, rezultatet tregojnë se gjykatat po përmirësohen, po bëjnë hapa për

t'u përgjigjur nevojave të qytetarëve", ka thënë Davis.

Skender Çoçaj, kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka theksuar se raportet e shoqërisë civile janë të dobishme dhe e ndihmojnë këtë institucion për të ndërmarrë veprime në përmirësim të gjyqësorit. "KGJK-ja mirëpret rekomandimet që vijnë nga shoqëria civile dhe do të vazhdojmë të punojmë së bashku me qëllim që ta rrisim transparencën në gjykata. KGJK do të angazhohet vazhdimisht për përmirësim të shërbimeve të gjykatave, transparencës dhe llogaridhënies", ka deklaruar ai.

Bashkim Hyseni, kryetar i Gjykatës Themelore të Ferizajt, u shpreh se kjo anketë tregon se gjykata që udhëheqë ai është lidere për efikasitet dhe se do të vazhdojnë të jenë dinamikë në zgjidhje të çështjeve gjyqësore dhe që të gjitha informacionet të jenë të qasshme.



Senatori Dole së shpejti me statujë në Prishtinë

Prishtinë, 25 shkurt (ER) - Senatori amerikan Bob Dole së shpejti do ta ketë gati statujën në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë. Kjo vepër arti do të jetë e punuar nga skulptori Luan Mulliqi. Me këtë rast, ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Philip Kosnett, i ka dorëzuar senatorit Dole fotografinë e statujës. "Ka qenë nder që personalisht t'ia dorëzoi personalisht fotografinë e statujës së senatorit Dole të punuar nga Luan Mulliqi që do të vendoset në Prishtinë. Njeri i mrekullueshëm", ka shkruar Kosnett në llogarinë e vet në "Twitter".

Osman Havolli, kryetar i Odës së Avokatëve të Kosovës, ka kërkuar që gjykatat të jenë më të hapura dhe transparente me avokatinë. Besnik Prekazi nga D+ ka paraqitur të gjeturat dhe rekomandimet që dalin nga anketa e prezantuar në këtë tryezë: "Hulumtimi është bërë me 1 681 përdorues të gjykatave, përmes dy anketave të ndara: prej tyre, njëra me 1 307 qytetarë me raste të hapura dhe tjetra 374

avokatë", ka thënë ai.

Prekazi ka thënë se në përgjithësi, sipas qytetarëve dhe avokatëve, gjykatat kanë një trend pozitiv në përmirësim të punës së tyre. "Për këtë D+ do të vazhdojë ta monitorojë përparimin e Gjykatave Themelore në zbatimin e rekomandimeve që kanë dalë nga ky hulumtim dhe të gjeturat do të publikohen në platformën online që D+ ka krijuar enkas për këtë çështje", ka thënë Prekazi.



Shqipëria merr vendim për hapjen e Konsullatës së Përgjithshme në Strugë

TIRANË, 25 SHKURT (ER) - Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë ka marrë vendim për hapjen e Konsullatës së Përgjithshme në Strugë, në Maqedoninë e Veriut. Lajmin e bëri të ditur ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj, në një postim në rrjetin "Facebook". Cakaj theksoi në postim se ky

vendim është në përputhje me planin për ta thelluar marrëdhënien e shtuar ndërveprimin me shqiptarët në rajon. Rrethi konsullor i kësaj qendre do t'i përfshijë Strugën, Ohrin, Manastirin, Kërçovën, Dibrën, Gjevgjelinë, Resnjën, rajoni liqeni i Prespës. Kjo konsullatë do të ketë rol të veçantë edhe në nxitjen e

mëtejme të marrëdhënieve ekonomike, shoqërore e kulturore mes tyre dhe Republikës së Shqipërisë. "Ne do të vazhdojmë marrjen e masave të reja në shërbim të forcimit të lidhjeve me shqiptarët dhe lartësimin të faktorit shqiptar në rajon!", ka thënë kryediplomati Cakaj në përfundim të reagimit të tij.



A po rrezikohet edhe Kosova nga koronavirusi?

Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) ka njoftuar të martën se në Klinikën Infektive janë paraqitur tri raste të dyshuara për koronavirus. Të tri rastet e dyshuara me koronavirus kanë ardhur nga Italia. Klinika Infektive ka theksuar se nuk ka nevojë për panik dhe shqetësim meqë janë vetëm raste të dyshuara. Të tre të dyshuarve u janë marrë mostrat për analizë dhe janë dërguar në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike për verifikim. Ministria e Arsimit ka kërkuar nga drejtoritë komunale të arsimit dhe shkollat masa të shtuara parandaluese rreth koronavirusit, ndërkaq në lidhje me këtë virus Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK) ka kërkuar nga ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, që të dihet se cilat janë kapacitetet e punëtorëve shëndetësorë për mbrojtjen e kësaj pandemie



EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 25 SHKURT - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) ka njoftuar të martën se në Klinikën Infektive janë paraqitur tri raste të dyshuara për koronavirus. Sipas njoftimit për media, personave të dyshuar që janë infektuar me koronavirus u janë marrë mostrat dhe janë dërguar në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike për verifikim. Të tri rastet e dyshuara me koronavirus kanë ardhur nga Italia. "Në Klinikën Infektive në QKUK sot janë paraqitur tri raste të dyshuara për koronavirus. Një shtetas jokosovar, 69 vjeç, i cili ka qëndruar në Itali. Dy shtetas të tjerë kosovarë, 25 vjeç dhe 23 vjeç, të cilët kanë ardhur sot nga Italia. Janë marrë mostrat për analizë dhe janë dërguar në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike për verifikim. Klinika Infektive njofton se nuk ka nevojë për panik dhe shqetësim meqë janë vetëm raste të dyshuara", është bërë me dije në njoftimin e QKUK-së.

Koronavirusi, punëtorët shëndetësorë me kërkesë publike drejtuar ministrit Vitia

Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK) përmes një kërkesë publike i është drejtuar ministrit të Shëndetësisë, Arben Vitia, lidhur me masat e parandalimit të koronavirusit. Në kërkesën drejtuar Vitisë, FSSHK-ja kërkon nga ministri që të dihet se cilat janë kapacitetet e punëtorëve shën-

detësorë për mbrojtjen e pandemisë së supozuar nga OBSH-ja me qëllim të luftimit të koronavirusit. "I nderuar z. Ministër, duke u nisur nga situata aktuale në mbarë globin tonë, po ju adresohemi me disa pyetje konkrete me qëllim të mospërhapjes së panikut në komunitetin tonë: 1. Cilat janë kapacitetet tona për mbrojtjen e pandemisë së supozuar nga OBSH-ja me qëllim të luftimit të koronavirusi COVID -19? 2. Cilat janë masat mbrojtëse përveç atyre që i proklamoni në lidhje me ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve shëndetësorë? 3. Cilat janë masat të cilat i keni ndërmarrë ju me ministritë përkatëse me qëllim të funksionalizimit shtetëror për parandalimin e kësaj pandemie të supozuar? 4. Sa është kostoja financiare e përlogarit me qëllim të parandalimit të kësaj pandemie (sipas OBSH-së)? Pra, i nderuar Ministër, duke parë situatën e krijuar që në medime tona, p. sh., nuk kemi asnjë komunikim me publikun për masat e parandalimit të kësaj pandemie të supozuar, ju lutem reflektoni.

Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës është e hapur edhe jashtë protokolleve burokratike që po i bëni të angazhohemi me qëllim të ruajtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë të punëtorëve shëndetësorë dhe popullatës, gjë të cilën jua kam transmetuar edhe përmes komunikimit privat. Edhe një herë ju lutem që të reflektoni dhe të merrni në konsideratë apelin tonë sepse situata e krijuar në këtë vend është përgjegjësi e secilit", është thënë në kërkesën e FSSHK-së, e cila drejtohet nga kryetari Blerim Sylja.

Koronavirusi, i cili është shfaqur për herë të parë në fund të vitit të kaluar në qytetin Wuhan të Kinës, shkakton infeksion të rëndë akut të frymëmarrjes dhe simptomat zakonisht fillojnë me ethe dhe kollë të thatë. Shifrat e fundit nga Kina tregojnë për 2 236 njerëz të vdekur dhe mbi 75 000 të infektuar. Koronavirusi është përhapur edhe në pjesën tjetër të Azisë, Evropës, ShBA dhe Afrikës. Aktualisht nuk ka vaksinë për të.

MASAT E PARANDALIMIT

1. Shmangia e kontaktit të ngushtë me njerëzit që vuajnë nga infeksione akute të frymëmarrjes.
2. Larja e shpeshtë e duarve, veçanërisht pas kontaktit të drejtpërdrejtë me njerëzit e sëmurë ose në vendqëndrimin e tyre.
3. Shmangia e prekjes së fytyrës dhe mbulimi i gojës dhe hundës me faculetë, me mëngë ose parakrahë gjatë kollës dhe teshtitjes. Hidhni faculetat e përdorura në shportën më të afërt të mbeturinave.
4. Nëse keni ethe, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje kërkon menjëherë ndihmë mjekësore dhe tregoni historinë eventuale të udhëtimit jashtë vendit.
5. Personat e sëmurë duhet të qëndrojnë në shtëpi në mënyrë që të parandalohet përhapja e sëmundjes.
6. Të evitohen vendet e mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.
7. Personat të cilët kanë qenë në provincën Wuhan, Kinë brenda dy javëve të fundit dhe kanë ethe, kollë ose vështirësi në frymëmarrje, duhet menjëherë të kërkojnë ndihmë mjekësore.
8. Brenda mjediseve të institucioneve të kujdesit shëndetësor, të forcohen praktikat standarde të parandalimit të infeksionit dhe kontrollit në spitale, veçanërisht në shërbimet e urgjencës.
9. IKSHPK rekomandon të gjithë që të mos udhëtojnë drejt Kinës, nëse nuk e kanë të domosdoshme. Në rast të ndryshimit apo përkeqësimit të situatës epidemiologjike me koronavirus në Kosovë, rekomandimet mund të pësojnë ndryshime dhe për to do të informoheni me kohë.

MASHTI kërkon nga DKA-të dhe shkollat masa të shtuara parandaluese rreth koronavirusit

Në bazë të rekomandimit të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKShP), Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë (MSh), kanë shpërndarë nëpër shkolla materiale vetëdijësuese rreth koronavirusit.

MASHTI, po ashtu, përmes Drejtorive Komunale të Arsimit ka kërkuar që në të gjitha shkollat në Kosovë ora e parë e mësimit të ndërrimit të pasdites sot (25.02.2020) dhe ora e parë e ndërrimit të paradites nesër (26.02.2020) t'i kushtohet rritjes së vetëdijësimit të nxënësve lidhur me masat parandaluese duke u bazuar në

materialet dhe udhëzimet e pranuar nga Instituti Kombëtar për Shëndet Publik, të cilat janë shpërndarë nëpër shkolla. Po ashtu, MASHTI i ka udhëzuar DKA-të që t'i pajisë shkollat me material higjienik dhe të gjitha institucionet shkollore të bëjnë dezinfektimin e shtuar të të gjitha sipërfaqeve dhe nyjave sanitare.

**NJOHËSIT E INTEGRIMEVE
EVROPIANE TREGOJNË NËSE DO
TË KETË LIBERALIZIM TË VIZAVE
PËR KOSOVËN KËTË VIT**



Njohësit e integrimeve: Duhet të punohet ende për liberalizim të vizave

Njohësit e integrimeve evropiane kanë bërë me dije se liberalizimi i vizave për Kosovën varet nga faktorë të jashtëm dhe të brendshëm. Demush Shasha dhe Avni Mazrreku kanë deklaruar për “Epokën e re” se mosluftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar, mungesa e vullnetit të disa vende të BE-së dhe ngecjet në procesin e dialogut Kosovë - Serbi janë faktorët kryesorë që po mbajnë të izoluar qytetarët e Kosovës. Sipas tyre, nëse adresohen këto çështje nga institucionet e Kosovës mund të shpresohet për një vendimmarrje pozitive gjatë vitit 2020 për liberalizimin e vizave

është konkluduar se korrupsioni është i përhapur në të gjitha nivelet institucionale dhe institucionet e drejtësisë janë duke ndërmarrë veprimet nën ndikimin politik. Kosova u konfirmua se është vend i fundit në Ballkan në kuadër të kapitujve të ndërlidhur me sundimin e ligjit - kapitulli 23 dhe 24. Mungesa e vullnetit politik për liberalizim të vizave. Brenda BE-së janë disa vende të cilat për arsye të brendshme janë kundër hapjes së mëtutjeshme të kufijve të BE-së. Këtu vende kyçe kundër janë Franca, Holanda dhe Danimarka”, ka thënë Shasha.

Gjithashtu, drejtori ekzekutiv i Institutit EPIK ka vlerësuar se mungesa e përparimit në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë është një pengesë indirekte në këtë proces. “Dialogu për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk është kriter i drejtpërdrejtë i

procesit të liberalizimit të vizave. Sidoqoftë, mungesa e progresit në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë është një pengesë indirekte pasi që vendet anëtare të BE-së e shohin bashkëpunimin rajonal si parakusht themelor në kuadër të të gjitha proceseve integruese, përfshirë edhe liberalizimin e vizave”, ka vlerësuar Shasha, duke shprehur optimizëm se në këtë vit mund të ketë lajme pozitive në këtë drejtim. “Në këtë kontekst, nëse institucionet e Kosovës i adresojnë detyrat e shtëpisë gjatë vitit 2020, atëherë mund të shpresojmë për një vendimmarrje pozitive gjatë vitit 2020 për liberalizimin e vizave”, ka thënë ai.

Ndërsa njohësi tjetër i integrimeve evropiane, Avni Mazrreku, ka deklaruar për gazetën “Epoka e re” se pengesa kryesore në këtë drejtim është mosnjohja e Republikës së Kosovës nga pesë vendet e BE-së. “Nëse kriteret e Kosovës për

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 25 SHKURT - Njohësit e integrimeve evropiane kanë përmendur faktorët të cilët janë duke penguar liberalizimin e vizave për Kosovën. Ata kanë bërë me dije se mungesa e rezultateve të Kosovës në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, mungesa e vullnetit të disa vendeve të BE-së dhe ngecjet në procesin e dialogut Kosovë - Serbi janë

faktorët kryesorë që po i mbajnë kosovarët të izoluar.

Drejtori ekzekutiv i Institutit EPIK, Demush Shasha, ka treguar për gazetën “Epoka e re” se faktori i parë që po ndikon në këtë aspekt është mungesa e rezultateve të Kosovës në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. “Tri vjet e gjysmë pas kërkesës së Komisionit Evropian për përmbushjen e kriterit të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, ne ende s’kemi

asnjë aktgjykim dënues të profilit të lartë për korrupsion. Rrjedhimisht, vendet anëtare të BE-së nuk e ndajnë mendimin se Kosova ka përmbushur kriteret për liberalizimin e vizave. Ky ishte së fundi edhe qëndrimi zyrtar i Ministrisë së Jashtme të Francës.

Sipas tij, raporti i vendit 2019 identifikoi sfida të shumta në fushën e sundimit të ligjit. “Në veçanti, vendet anëtare me shqetësim janë duke përcjell të gjeturat e Raportit të Vëndit, ku

liberalizim të vizave i krahasojmë me kriteret që i kanë pasur vendet e tjera, shihet se Kosova ka pasur kriteret të dyfishta dhe kriteret që vendet e tjera nuk i kanë pasur në këtë proces. Prandaj, BE-ja, pavarësisht se Kosovës i ka deklaruar perspektivën evropiane, vendimmarrja politike në BE është e vështirë e parashikueshme, kur dihet se mungojnë pesë anëtarë të BE-së që nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës”, ka thënë Mazrreku. Sipas tij, BE-ja në vend se të bëjë presion te vendet anëtare që nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës, ajo i shton kriteret për liberalizim të vizave. “Megjithatë, këtë kontradiktë brenda strukturave të BE-së, në vend se Bashkimi Evropian të bëjë presion mbi ato pesë shtete që nuk e kanë njohur Kosovën, BE-ja vazhdon të vendosë kriteret për Kosovën të cilat nuk janë

aplikuar në ndonjërin nga vendet që kanë përfituar nga procesi i liberalizimit të vizave. Përderisa ekziston kjo situatë, koha se kur do të merret vendimi për liberalizimin vizave është vështirë e parashikueshme”, ka thënë ai, duke shtuar se edhe strukturat e brendshme të shtetit të Kosovës nuk e kanë adresuar dhe qartësuar këtë çështje siç duhet.

Mazrreku ka vlerësuar se zyrtarët e lartë të BE-së që e përfaqësojnë këtë mekanizëm në dialogun Kosovë - Serbi nuk mund të garantojnë asgjë në emër të BE-së për procesin e liberalizimit të vizave. Përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe të sigurisë nuk mund të garantojë asgjë në emër të BE-së, sepse ky përfaqësues nuk e merr vendimin për liberalizim të vizave. Këtë vendim e marrin shtetet anëtare të BE-së dhe këto shtete nuk e kanë dorëzuar atë

kompetencë në këtë institucion”, ka deklaruar Mazrreku.

Liberalizimi, prioritet i qeverisë së re

Ministri i Integritimit Evropian, Blerim Reka, me të marrë mandatin, ka bërë me dije se liberalizimi i vizave do të jetë prioritet i Qeverisë Kurti. Ai ka thënë se për të ndodhur liberalizimi duhet të luftohet korrupsioni dhe krimi i organizuar. “Unë jam përmbajtur nga deklarimet, citimi me data, me ditë, me muaj, sepse procesi i liberalizimit, ndonëse është proces teknik i plotësimit të kriterëve megjithatë, siç po shihet në rastin e Kosovës në finalen e saj, pas plotësimit të 95 kriterëve të Komisionit Evropian, janë disa hezitime të, së paku, dy shteteve anëtare të BE-së dhe atë me mosbindjen e

tyre që Kosova nuk ka ofruar ende prova bindëse për luftimin e korrupsionit, sidomos në rastet e profilin të lartë”, ka thënë Reka.

Kurse ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, në konferencën e nivelit të lartë lidhur me perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor “Nga Selaniku në Zagreb”, ka kërkuar liberalizimin e vizave për Kosovën. “Në fjalimin e mbajtur kam theksuar përkushtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës në rrugën drejt integritimeve evropiane si dhe përkushtimin për t'i vazhduar reformat në rrugën e integritimit evropian. Ndër të tjera, kam kërkuar vendimin pozitiv për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës në mënyrë që mos të izolohet rinia nga perspektiva e saj”, ka thënë Konjufca.

Në konferencë edhe ministri në detyrë i Shqipërisë për Evropën dhe Punët e Jashtme i Shqipërisë, Gent Cakaj, ka kërkuar liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. “Nënvizuam rëndësinë e veçantë të liberalizimit të vizave me Republikën e Kosovës jo vetëm për qytetarët e saj, por edhe për ta ruajtur besueshmërinë e BE-së në rajon.

Theksuam domosdoshmërinë për t'i çelur negociatat me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut”, ka shkruar Cakaj në llogarinë e vet në “Facebook”.

Këshilli i BE-së, si institucion përgjegjës për liberalizimin e vizave për Kosovën, respektivisht Këshilli për Punë të Brendshme, do të takohet më 12 mars të këtij viti. Deri më tani nuk janë dhënë indikacione se liberalizimi i vizave për Kosovën do të jetë pjesë e agjendës.

Veliu: Policia e Kosovës ende ka para vetes sfida të mëdha



Ministri i Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Agim Veliu, ka vizituar të martën Policinë e Kosovës. Ai së bashku me drejtorin e Përgjithshëm të PK-së, Rashit Qalaj, vizituan kampin “Vrella”, ku janë të vendosura njësitë speciale të Policisë së Kosovës. Veliu ka theksuar se Policia e Kosovës para vetes ka ende sfida të mëdha. “Në mesin e atyre janë: forcimi i luftës kundër të gjitha formave të krimit të organizuar, korrupsionit, ekstremizmit të dhunshëm, terrorizmit, krimeve ekonomike dhe menaxhimi i migrimit”, ka thënë Veliu

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 SHKURT - Ministri i Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Agim Veliu, ka vizituar të martën Policinë e Kosovës. Me këtë rast, ministri Veliu është pritur nga drejtori i Përgjithshëm i PK-së, Rashit Qalaj dhe zyrtarët e lartë të PK-së. Gjatë kësaj vizite ministrit Veliu iu prezantuan objektivat strategjike, aktivitetet në realizim të tyre, sfidat dhe të arriturat e policisë në aspektin e përgjithshëm. Më pas, ministri i MPBAP-së dhe drejtori i Përgjithshëm i PK-së, Rashit

Qalaj, vizituan kampin “Vrella”, ku janë të vendosura njësitë speciale të Policisë së Kosovës.

Duke iu drejtuar efektivëve të njëjësive speciale, ministri Veliu ka theksuar se Policia e Kosovës ka arritur rezultate, por se ka edhe sfida të shumta. “Policia e Kosovës para vetes ka ende sfida të mëdha. Në mesin e atyre janë: forcimi i luftës kundër të gjitha formave të krimit të organizuar, korrupsionit, ekstremizmit të dhunshëm, terrorizmit, krimeve ekonomike dhe menaxhimi i migrimit”, ka thënë ministri Veliu, duke u zotuar se gjatë mandatit të tij si ministër i MPBAP do ta përkrahë fuqishëm Policinë e

Kosovës në mënyrë që në vend të mbizotërojnë rendi dhe ligji.

Ministri Veliu u zotua se në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisë, prioritet i tij do të jetë edhe përmirësimi i kushteve të zyrtarëve policorë dhe çështje të tjera me rëndësi për Policinë e Kosovës. Po ashtu, edhe drejtori i Përgjithshëm i PK-së, Rashit Qalaj, mbajti një fjalim të shkurtër, ku falënderoi ministrin për vizitën. Më pas ata së bashku panë nga afër disa nga pajisjet e ekspozuara të njëjësive speciale. Vizita e ministrit të MPBAP-së, Agim Veliu, përfundoi me një vizitë në Qendren Operative të PK-së në Prishtinë.

Italia vazhdon ta përkrahë Kosovën në rrugën integruese në BE

PRISHTINË, 25 SHKURT (ER) - Ministri i Integritimit Evropian, Blerim Reka, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Italisë në Kosovë, Nicola Orlando. Ministri Reka i shprehu ngushëllime ambasadorit Orlando për viktimat e fundit nga koronavirusi në Itali dhe i shprehi përkrahje morale për këto ditë të vështira nëpër të cilat është duke kaluar Italia nga kjo sëmundje.

Më tej, në takim u bisedua për procesin integrues të Kosovës në BE. Siç rekomandoi ministri Reka, është e pakuftueshme që edhe më tutje qytetarët e Kosovës të mbahen të mbyllur si në një ishull të Shengenit, pa pasur mundësinë për të qarkulluar lirshëm dhe pa regjim

të vizave në Evropë.

Gjithashtu, ministri Reka kërkoi që të jetë zëri i Kosovës edhe te pesë shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën sepse, siç tha, është e pakuptueshme që një organizatë multilaterale siç është BE-ja të ndërmarrë vendime unilaterale. "Kjo çështje është ngritur sidomos për arsyen se e dëmton jo vetëm procesin integrues, por edhe në përgjithësi procesin e njohjeve të tjera ndërkombëtare të Kosovës", ka thënë ai. Reka kërkoi përkrahjen dhe mbështetjen e Italisë edhe në procesin e përgjithshëm integrues, përfshirë këtu edhe çështjen e përgatitjes për aplikim të Kosovës për statusin e shtetit kandidat për anëtarësim në Bashkimi

Evropian.

Ambasadori Orlando e ka njoftuar ministrin Reka për masat e gjera të marra të tashmë në Itali për ta penguar përhapjen e koronavirusit, duke përfshirë kontrollin dhe identifikimin e plotë të disa zonave potencialisht të prekura dhe të individëve, pezullimin e tubimeve publike dhe forcimin e monitorimit mjekësor të kufirit në pikat e kalimit.

Ambasadori Orlando konfirmoi mbështetjen e Italisë për aspiratën e integritimit evropian të Kosovës. Ai rikonfirmoi rëndësinë e liberalizimit të vizave për qytetarët e saj dhe partneritetin e Italisë për përparimin e mëtutjeshëm të Kosovës në Agjendën Evropiane të Reformës.



Minxhozi ofron përkrahjen e Shqipërisë për avancimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të FSK-së

PRISHTINË, 25 SHKURT (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi. Në fillim, ambasadori Minxhozi uroi ministrin Quni dhe përcolli urimet nga ana e homologes së tij, ministres Xhaçka. Duke vlerësuar lart personalitetin dhe profilin ushtarak dhe politik të ministrit Quni, ai shprehu besimin e plotë në suksesin e ministrit dhe forcën në proceset në të cilat po kalon. Gjithashtu, ambasadori Minxhozi shprehu konsideratën e lartë për nivelin e deritashëm të bashkëpunimit bilateral duke shprehur gatishmërinë e plotë dhe ofruar të gjitha kapacitetet shtetërore të Shqipërisë.

Si vend anëtar i NATO-s, ai ofroi mbështetjen e rezervë në



zhvillimin dhe avancimin e aftësive dhe kapaciteteve

operacionale të FSK-së dhe afirmimin e Kosovës për aderim

në mekanizmat e sigurisë rajonale dhe euroatlantike.

Ministri Quni falënderoi ambasadorin dhe shprehu mirënjohjen e thellë për mbështetjen e përhershme të Republikës së Shqipërisë në të gjitha periudhat dhe në arritjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës. Ai, ndër të tjera, foli edhe kontributin në profesionalizimin e kuadrove ushtarake të FSK-së përmes trajnimeve dhe shkollimeve si dhe kontributin e oficerëve shqiptarë në kuadër të ekipit këshillëdhënës të NATO-s. Ministri Quni theksoi nevojën e shtimit të aktiviteteve dhe thellimit të mëtejshëm të bashkëpunimit dhe marrëdhënieve vëllazërore mes dy shteteve, ministrive dhe forcave në funksion të interesave të përbashkëta dhe në funksion të paqes, stabilitetit dhe sigurisë rajonale dhe më gjerë.

Nënshkruhet kontrata për matjen e cilësisë së ujit në shkollat e Kamenicës

KAMENICË, 25 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka nënshkruar kontratën me Qendrën Regjionale të Shëndetit Publik (QRShP) në Gjilan për matjen e cilësisë së ujit në shkollat e Kamenicës që furnizohen me ujë nga pusët. Kjo është



bërë me kërkesë të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) drejtuar Komunës së Kamenicës muaj më parë. Si vazhdimësi e këtij problemi,

KDI-ja të martën ka organizuar tryezë diskutimi rreth cilësisë së ujit në shkollat e Kamenicës, Gjilanit dhe Vitisë me zyrtarët e këtyre komunave. Në këtë tryezë është diskutuar rreth

hapave që janë ndër-marrë deri më tani si dhe hapat që duhet të ndërmerren në të ardhmen në mënyrë që të bëhet një zgjidhje permanente për përmirësimin e cilësisë së ujit në shkollat të cilat furnizohen me pusë. Projekti "Rritja e llogaridhënies së institucioneve të qeverisjes lokale" realizohet me fonde të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë.



Kurti emëron Erzen Vraniqin këshilltar politik

PRISHTINË, 25 SHKURT - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka emëruar Erzen Vraniqin këshilltar politik. Me këtë rast, kryeministri Albin Kurti, Vraniqit i ka uruar

punë të mbarë në detyrën e re, duke shtuar se përvoja e tij politike dhe angazhimi tejet profesional i deritanishëm do të jenë të rëndësishëm në rrugëtimin e përbashkët politik.

Aktakuzat e para në Gjykatën Speciale tanimë janë ngritur!



Tomë GASHI

Nuk është aspak sinjal i mirë që Prokuroria të kërkojë nga kryetarja e Gjykatës që të caktojë gjyqtarë të procedurës paraprake sepse kjo i bie se një apo më tepër aktakuzat janë të gatshme.

Sido që të jetë tani, me çdo gjë është duke u ditur që Gjykata Speciale pas pesë viteve të themelimit të saj, mjerisht nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe mbi dy vjet pas funksionalizimit të saj, do t'i ngritë aktakuzat e para, gjë që do të jetë tepër e dëmshme për shqiptarët në përgjithësi, për shqiptarët e Kosovës në veçanti, e posaçërisht për ish-pjesëtarët e UÇK-së.

Unë besoj se fajin kryesor që ka ardhur deri te formimi i Gjykatës Speciale e kanë disa prej udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që në emër të UÇK-së kanë bërë trysni te deputetët, posaçërisht të partive të tyre, që ta themelojnë Gjykatën Speciale me pretendime se kine kjo është në të mirë, siç thonë ata, të vërtetimit të pastërtisë së luftës së UÇK-së, ndërsa që të jetë ironia edhe më e madhe kur ata janë ftuar në Gjykatën Speciale në Hagë, ata thjesht kanë

heshtur, janë mbrojtur në heshtje, dhe tani është pak sa e pakuptueshme se si kanë mundur ta vërtetojnë pastërtinë e luftës së UÇK-së duke u mbrojtur në heshtje.

Mbrojtja në heshtje në shumë raste është strategji e mirë fillestare juridike, por në aspektin politik është paksa e pakuptueshme se si mund të mbrosh apo vërtetosh diçka pa folur fare.

Ende askush nuk e di, se kush mund të jenë të akuzuarit e parë, sepse aktakuzë me një person nuk do të kemi, por definitivisht nuk do të ketë fare tronditje të skenës politike në Kosovë, sepse tanimë kemi një qeveri të themeluar në mënyrë demokratike dhe destabilizim nuk do të ketë, mund të ketë shfaqje sporadike të pakënaqësisë, gjë që është krejtësisht normale, mund të ketë protesta, të cilat po ashtu mund të jenë normale, por destabilizim nuk do të lejohet që të ketë, sepse fundi i fundit Kosova si shtet ka qenë edhe projekt amerikan dhe në asnjë rast ata që do të akuzohen nuk e kanë më fuqinë e vendimmarrjes dhe gjithçka do të jetë shprehje e pakënaqësisë, por pakënaqësia duhet të drejtohet tek ata që e kanë votuar Gjykatën Speciale, e jo te Qeveria e kryeministrit Albin Kurti sepse, siç të gjithë e mbajmë në mend, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje jo vetëm që nuk e kanë votuar Gjykatën Speciale, por ata e kanë lëshuar edhe Kuvendin e Republikës së

Kosovës kur është votuar kjo Gjykatë, duke shprehur pakënaqësinë e tyre ndaj atyre që insistonin që kjo Gjykatë të formohej.

Do të mbahet mend fjalimi i Albin Kurtit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbetet në histori, i cili u mundua që ta parandalojë themelimin e kësaj Gjykate, por një pjesë e udhëheqësve të UÇK-së që kishin fuqi thuajse të pakufizuar politike, insistonin që gjithsesi të formohet kjo Gjykatë.

Duke menduar se ata vetë nuk do të jenë shënjestër e saj, por gjërat ndryshuan, pastaj më 22 dhjetor 2017, dy ditë para Krishtlindjeve, duke menduar se zyrtarët e lartë ndërkombëtarë dhe ambasadorët e shteteve të fuqishme kanë ikur në shtetet e tyre për shkak të Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri, ata tentuan ta zhbëjnë Gjykatën Speciale, por as kjo nuk kaloi, sepse nuk mund të zhbëheshin diçka që vetë e kishin krijuar.

Pastaj të njëjtit u tërhoqën nga kjo tentativë dhe situata mbeti e njëjtë, do të mbetet e njëjtë, sepse me ligjin e Gjykatës Speciale, kryeministri Albin Kurti, qeveria e tij dhe as Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk mund ta zhbëjnë Gjykatën Speciale, nuk mund ta ndalojnë punën e saj, sepse kështu kanë vendosur deputetët e Republikës së Kosovës, ata që e votuan këtë gjykatë më 3 gusht të vitit 2015.

Frika më e madhe është se prokurorët e Gjykatës Speciale

nuk janë ngutur dhe duket që kanë punuar me vite të tëra që të sigurojnë prova kundër pjesëtarëve të UÇK-së, e që është edhe më keq me ligj nuk është parandaluar që të përdoren edhe provat e siguruar nga organet e ndjekjes në Serbi, siç janë Prokuroria për Krime të Luftës në Serbi dhe organe të tjera, ndërsa është çështje tjetër se sa këto mund të kenë kredibilitet - besueshmëri në Gjykatën Speciale.

Vetëm shqiptarët e Kosovës kanë votuar një Gjykatë kundër vetvetes, me pretendime që truri i shëndoshë nuk i kupton, që duke krijuar Gjykatë kundër vetvetes do ta pastrojnë luftën e UÇK-së.

Se ka qenë luftë e drejtë nga UÇK-ja dhe luftë mbrojtëse këtë askush nuk e ka kontestuar, të gjithë e dinë, dhe për këtë arsye ne gjatë vitit 1998-1999 kishim edhe aleatët kryesorë të shteteve demokratike, që na ndihmuan aq shumë të çlirohemi nga Serbia, saqë për 78 ditë, nga 24 mars deri më 12 qershor 1999, e bombarduan Serbinë për ta mbrojtur popullin shqiptar të Kosovës nga gjenocidi, pastrimi etnik, nga vrasjet masive, dhunimet dhe torturat çnjerëzore që nuk ishin parë që nga Lufta e Dytë Botërore, saqë Serbia tentoi që ta shfarosë popullin shqiptar nga Kosova, duke na vrarë dhe duke na dëbuar gjysmën e popullatës jashtë territorit të Kosovës.

Ne u çliruam me ndihmën e NATO-s, e posaçërisht të Amerikës, e cila pas luftës së

UÇK-së dhe të popullit shqiptar të Kosovës u vu në shërbimin tonë që të na shpëtojë.

Pretendimet se nëse ne nuk do ta kishim krijuar Gjykatën Speciale këtë do ta bënte OKB-ja, me gjyqtarë rusë dhe kinezë, nuk është fare e vërtetë. OKB-ja kurrë nuk do të krijonte gjykatë raciste kundër një nacionaliteti, në një shtet shumetnik, sepse në Kosovë nuk ka pasur luftë civile, por ka pasur luftë mbrojtëse nga ana jonë, në krye me UÇK-në dhe NATO-n, ndërsa në anën tjetër okupim total ushtarak policor nga Serbia.

OKB-ja nuk do të formonte një gjykatë njënacionale, sepse do t'i dëmtonte rëndë themelet e saj të mosdiskriminit racor, fetar gjinor etj., edhe varianti më i keq që do të ishte shumë më i mirë se Gjykata Speciale, do të krijohej një gjykatë për t'i gjykuar të gjithë ata për të cilët ka prova se kanë kryer vepra penale të krimeve të luftës gjatë luftës në Kosovë, e që janë Forcat Ushtarake Serbe që vranë mbi 15 mijë civilë shqiptarë, mbi një mijë fëmijë, dhunuan mbi njëzet mijë gra e vajza në Kosovë, e shkatërruan Kosovën në tërësi duke e bërë shkru mb e hi.

Me delegimin e sovranitetit juridik, në territorin e shtetit të Holandës, ne thuajse fatin tonë e kemi lënë në duar të huaj dhe, që është më e keqja, e kemi dëmtuar rëndë UÇK-në në emër të UÇK-së.

Tanimë jemi në situatën ku aktakuzat e para në Gjykatën Speciale janë ngritur!

Osmani: Njohja e pavarësisë nga Vatikani, njohje e sakrificës së popullit të Kosovës

PRISHTINË, 25 SHKURT (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, i kërkoj të martën imzot Jean-Marie Speich, delegat apostolik për Kosovë, që t'ia përcjellë papatit mesazhin e qytetarëve të Kosovës dhe të institucioneve të saj që ta konsiderojë njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Selia e Shenjtë. "Njohja e pavarësisë së vendit tonë jo vetëm do t'i ngritë në një nivel më të lartë marrëdhëniet tona edhe ashtu të shkëlqyera, por do të ishte edhe njohje e sakrificës së popullit të Kosovës për liri", ka thënë Osmani. Ajo ka shprehur gatishmërinë e saj dhe të Kuvendit të Republikës që ta vazhdojnë bashkëpunimin me Selinë e Shenjtë.

Në anën tjetër, imzot Jean-Marie Speich ka shprehur

kënaqësinë e tij për zgjedhjen e Osmanit në krye të Kuvendit të Kosovës dhe ka nënvizuar përkushtimin e tij dhe të Selisë së Shenjtë për ta thelluar edhe më tutje bashkëpunimin me popullin e Kosovës dhe me institucionet e vendit. Sipas tij, raportet e mira me Kosovën tregojnë kujdesin që papa dhe Selia e Shenjtë kanë treguar në vazhdimësi ndaj popullit të Kosovës. Sipas tij, pavarësisht faktit se në mes të Kosovës dhe Selisë së Shenjtë ende nuk janë vendosur raporte formale diplomatike, ekziston një gatishmëri e madhe që bashkëpunimi të zhvillohet në më shumë fusha, veçanërisht në edukimin e mirëfilltë të rinisë së Kosovës.

Edhe kryeministri Albin Kurti e ka prituri në takim Nuncin apostolik në Slloveni dhe me



delegim në Kosovë, imzot Jean-Marie Speich. Biseda mbi temat

nisi me urimin për qeverisjen si dhe me faktin se vështirësitë

janë të mëdha, aq sa janë edhe të larta pritshmëritë.

KEK-u në tre vjetët e ardhshëm parasheh investime 437 milionë euro

Korporata Energjetike e Kosovës në tre vjetët e ardhshëm ka nevojë të realizojë investime të mëdha kapitale, vlera e të cilave do të arrijë 437 milionë euro. Drejtuesit e Korporatës konsiderojnë se këto janë investime të domosdoshme për të garantuar siguri dhe stabilitet energjetik në Kosovë për 40 vjetët e ardhshëm

EPOKA E RE
Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 SHKURT - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) në tri vitet në vijim ka nevojë të realizojë investime të mëdha kapitale, vlera e të cilave do të arrijë në rreth 437 milionë euro.

Drejtuesit e Korporatës konsiderojnë se këto janë investime të domosdoshme për të garantuar siguri dhe stabilitet energjetik në Kosovë për 40 vjetët e ardhshëm. Investimi më i madh kapital parashihet të bëhet në zgjerimin e minierës ekzistuese dhe hapjen e minierës së re, po ashtu edhe rehabilitimi i termocentralit "Kosova B". "Në

Termocentralin 'Kosova B' duhet të investohen rreth 270 milionë euro që do të mundësojnë ngritjen e besueshmërisë dhe zgjatjen e jetës së termocentralit, si dhe arritjen e parametrevave të ndotjes sipas standardeve të Bashkimit Evropian. Kjo nevojë ka rezultuar në bazë të studimit të fizibilitetit të financuar nga BE-ja, që i është prezantuar edhe Aksionarit (Qeverisë së Kosovës) që në maj të vitit 2017", thuhet në njoftimin e KEK.

Drejtori menaxhues i KEK-ut, Njazi Thaçi, ka thënë se prej këtyre investimeve, rreth 76 milionë janë grante të ndara nga Bashkimi Evropian për ndërtimin e elektrofiltrave të rinj dhe denoksit,

ndërsa pjesa tjetër parashihet të bëhet nga Korporata Energjetike e Kosovës, ku po shihet se vetëm tani kanë filluar problemet e theksuara në kaldajë për shkak të vjetërsisë së gypave. "Po ata gypa janë paraparë të ndërrohen në vitet 2020-2021. Edhe në vitin e kaluar e kemi njoftuar Qeverinë e Republikës së Kosovës në lidhje me sfidat dhe me vështirësitë që do t'i kemi në të ardhmen nëse nuk do të financohen këto projekte. Me çmimin aktual të energjisë që kemi ne, edhe pse e kemi një fitim, e kemi të pamundur që me atë fitim t'i mbulojmë të gjitha këto shpenzime. Prandaj, kërkesa jonë është që të ketë ndihmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës ose të ketë një rritje të tarifës së energjisë elektrike, për të cilën kemi bërë kërkesë apo i kemi dërguar ofertë kompanisë KEDS", ka deklaruar Thaçi. Sipas tij, realizimi i këtij projekti do të ndikojë në operimin më stabil, në disponueshmërinë e njësive dhe në sigurinë e prodhimit të

energjisë elektrike që do ta garantojë sigurinë energjetike të vendit dhe siguri të furnizimit sa më stabil nga termocentralet. "Rehabilitimi i termocentralit 'Kosova B' e zgjatë jetëgjatësinë edhe për 25 vjetët e ardhshëm, i cili do të operojë sipas standardeve evropiane sa i përket pjesës ambientale. Po ashtu, do të rritet edhe siguria e furnizimit apo siguria e punës së blloqeve gjeneruese në termocentralin 'Kosova B' si në gjenerator, po ashtu edhe në turbinë. Po ashtu, edhe në kaldajë do të ketë investime, pasi do të preken disa zona apo shumica e zonave që ne kemi probleme të vazhdueshme për shkak të vjetërsisë së pajisjeve", ka thënë Thaçi.

Ndërsa drejtori i Termocentralit "Kosova B", Luigj Imeri, ka deklaruar se nga 15 prilli i këtij viti do të fillojë realizimi i punëve në investimet e parashikuara. "Do të ndalet njësia B1 nga ku do të fillojë demolimi i elektrofiltrave dhe në anën tjetër rikonstruktimi për pjesën e kaldajës, për zvogëlimin

dENOX-it. Ky është një projekt jashtëzakonisht i mirë, të cilin tanimë veç po e finalizojmë. Studimi i fizibilitetit të cilin jemi duke e implementuar tash ka dy komponentë: komponentin ambiental dhe atë të zgjatjes së jetëgjatësisë. Këto janë të ndërlidhur me njëri-tjetrin sepse kanë ndikime në proceset teknologjike. Gjithashtu, nuk ka kuptim të investosh në ambient dhe të mos investosh në teknologji", ka thënë Imeri. Sipas tij, sa i përket prodhimit të qymyrit, nga studimi i kryer prej kompanisë gjermane Mibrag, nevojitet të parashihet hapja e mihjes së re që do ta mundësojë furnizimin me lëndë të parë për termocentralet ekzistuese dhe termocentralin "Kosova e Re".

Gëzim Tërnavë, këshilltar profesional për xehetari, ka thënë se KEK-u momentalisht operon me minierën Sibovci Jug-Perëndim, me një prodhim mesatar prej 8 milionë tonësh për vit, që plotëson kërkesat e kapaciteteve gjeneruese.



ATK-ja gjobitë 48 mijë euro bizneset transportuese që nuk kanë printuar kuponë fiskalë

PRISHTINË, 25 SHKURT (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) gjatë këtyre ditëve ka zhvilluar aksion në Prishtinë me qëllim të verifikimit të bizneseve me veprimtari transportuese, nëse janë duke vepruar konform dispozitivave ligjore për pajisje me arka fiskale dhe lëshim të kuponit fiskal.

Gjatë aksionit në fjalë janë inspektuar 41 biznese, ku si

rezultat 34 prej tyre kanë qenë të fiskalizuar, 20 prej tyre nuk kanë printuar kuponë fiskalë, ndërsa shtatë të tjera nuk kanë pasur të instaluar pajisjet elektronike fiskale.

Nga konstatimet e bëra në terren janë lëshuar 221 gjoba mandatore, në vlerë prej 48,375 eurosh. "Procesi i fiskalizimit është një proces permanent, i cili ndërlidhet me paraqitjen e bizneseve të reja në treg

(regjistrimin e tyre), si dhe daljen nga tregu të atyre ekzistueseve (ndërprerjen e veprimtarisë apo heqjen dorë nga mënyra e shitjes me para të gatshme)", thuhet në njoftimin e ATK-së.

Sipas këtij njoftimi, aksionet e ngjashme do të zhvillohen edhe ditëve në vijim, në mënyrë që gjithë tatimpaguesit të kenë trajtim të barabartë nga ATK-ja gjatë zbatimit të Legjislacionit Tatimor.



Së shpejti fillon zbatimi i fondit 17 milionësh për efizienzë të energjisë

Drejtori menaxhues i Fondit Kosovar për Efizienzë të Energjisë, Admir Shala, ka bërë me dije se Zyra e Bashkimit Evropian ka ndarë 10 milionë euro për Fondin për Efizienzë, ndërsa Banka Botërore participon me 5 milionë euro. “Marrëveshja pritet të nënshkruhet së shpejti me qeverinë e re, respektivisht me ministrin e Financave, Besnik Bislimi dhe do t’i kemi në dispozicion 17 milionë euro”, ka thënë Shala



duke vazhduar me rekrutimin e inxhinierëve dhe stafin e prokurimit për ta kompletuar ekipin”, ka thënë Shala për gazetën “Epoka e re”.

Vitin që lamë pas Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) që asokohe udhëhiqej nga Valdrin Llluka ka lansuar Fondin e Kosovës për Efizienzë të Energjisë.

Fondi i Kosovës për Efizienzë të Energjisë, si entitet i rëndësishëm, i pavarur, autonom dhe i qëndrueshëm është themeluar me miratimin e Ligjit për Efizienzën e Energjisë për t’i arritur objektivat e Kosovës në këtë sektorë.

Kurse Natalya Apostolova, udhëheqëse e Zyrës së BE-së në Kosovë, kishte thënë se janë adaptuar të gjitha ligjet për efizienzë, por që tash duhet zbatimi i tyre në praktikë. “Energjia në Kosovë është prioritet i BE-së. Ky është thelbi i çdo reforme në Kosovë. Edhe pse kemi probleme me energji, energjia efiçente është me rëndësi”, pati thënë Apostolova.

qeverinë e re, respektivisht me ministrin e Financave, Besnik Bislimi dhe do t’i kemi në dispozicion 17 milionë euro. Në fillim të vitit të kaluar, kur hyri në fuqi ligji për efizienzë të energjisë, është krijuar baza për themelimin e Fondit për Energji. Më 27 janar ka qenë takimi i parë i Bordit të Drejtorëve që më vonë

është shpallur konkursi për rekrutimin e drejtorit menaxhues, një proces ky që ka zgjatuar deri në gusht dhe unë kam filluar punën më 2 shtator dhe i kemi hapur konkurset për rekrutimin e stafit. Deri më tani i kemi marrë udhëheqësin e financave, atë të operacioneve dhe zyrës ligjore. Ndërkohë jemi

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 25 SHKURT - Drejtori menaxhues i Fondit Kosovar për Efizienzë të Energjisë, Admir Shala, ka thënë se ky fond kap shumën prej 17 milionë eurosh dhe ka për qëllim efizienzën e energjisë. Sipas tij, ky fond do të ndikojë në mirëqenien e qytetarëve dhe në rritjen ekonomike. “Fondi i Kosovës është i pari në rajon. Këtë fond nuk e ka as Shqipëria, as Mali i Zi, as Maqedonia, as Bosnja dhe

as Serbia. Falënderojmë donatorët e huaj, zyrën e BE-së, Bankën Botërore, por edhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Qeverinë e Kosovës që kishin në fokus kursimin e energjisë”, ka thënë Shala.

Ai në këtë bisedë për gazetën “Epoka e re” ka thënë se zyra e Bashkimit Evropian ka ndarë 10 milionë euro për Fondin për Efizienzë, ndërsa Banka Botërore participon me 5 milionë euro. “Marrëveshja pritet të nënshkruhet së shpejti me

Për ndërmarrjen “Trepça” kërkohet monitorim i veçantë nga Kuvendi

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 25 SHKURT - Komisioni për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike, nën kryesimin e Endrit Shalës nga Nisma Socialdemokrate, ka mbajtur të martën një diskutim lidhur me detyrat, prioritetet dhe organizimin e punës së këtij komisioni.

Shala ka shpalosur disa prej prioritetëve të këtij komisioni për monitorimin e agjencive të pavarura dhe të qeverisë. “Më lejon t’i propozoj disa prioritetëve. Dis prej tyre janë: shqyrtimi i projektligjeve, hartimi i nismave legjislative, mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit, mbikëqyrja e punës së ministrisë në baza tremujore, monitorimi i zbatimit të marrëveshjeve në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, monitorimi i marrëveshjeve

Kosovë - Serbi, bashkëpunimi me odat ekonomike dhe shoqërinë civile”, ka thënë Shala.

Ndërsa anëtari i këtij komisioni nga radhët e PDK-së, Ferat Shala, ka kërkuar që pjesë e aktiviteteve të jetë edhe monitorimi i ndërmarrjes “Trepça”. “Mendoj se këtij komisioni duhet t’i shtohet edhe pjesa e monitorimit të ndërmarrjes “Trepça”. Është e vetmja ndërmarrje minerare dhe që Qeveria e Kosovës është aksionare. Ta fusim si pikë të veçantë të monitorimit këtë ndërmarrje”, ka thënë Shala.

Me këtë rast, anëtari i këtij komisioni nga Lëvizja Vetëvendosje, Hekuran Murati, ka thënë se nuk është e nevojshme të specifikohen me emra ndërmarrjet publike, por me një konstatim të tillë nuk është pajtuar Shala. “Asnjë ndërmarrje nuk është e rregulluar me ligj të veçantë. “Trepça” është shoqëri aksionare.

Duhet ta presim të na vijë me urgjencë organogrami i ministrive të linjës”, është shprehur Shala.

Më tutje, anëtari i Komisionit për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike nga AAK-ja, Pal Lekaj, ka kërkuar që ta ftojë në raportim ministren Rozeta Hajdari për t’i informuar se si do të fuzionohen ministrinë të cilat janë shkruar në një të vetme. “Duhet ta ftojë ministren që të vijë dhe të raportojë se si do të fuzionohen të gjitha ministrinë në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik”, ka deklaruar Lekaj. Kurse anëtarja e këtij komisioni nga Lëvizja Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka kërkuar që të zbatohet kuota gjinore për ndërmarrjet publike. “Kjo është një komponentë që duhet të kemi kujdes dhe ta marrim në komision punën e terrenit”, ka thënë ajo. Pas diskutimeve, kryetari i Komisionit për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike, Endrit Shala, ka konstatuar se në parim ky komision ka përcaktuar objektivat e veta. Si përfundim, në këtë mbledhje është konkluduar se pasi të vijë plani legjislativ nga qeveria, komisioni të vendosë për monitorim të ndërmarrjeve publike.

Po ashtu, në këtë komision u



Konstituohet Komisioni për Buxhet dhe Transfere, drejtohet nga Hekuran Murati

Të martën është konstituuar Komisioni për Buxhet dhe Transfere, i cili funksionon në kuadër të Kuvendit të Kosovës. Ky komision drejtohet nga deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Hekuran Murati, ndërsa anëtarë të tij janë Haxhi Shala, Fikrim Damka, Klutim Gashi, Mimoza Kusari-Lila, Bedri Hamza, Fatmir Rexhepi, Yllza Hoti, Shkumbin Demaliaj, Verica Ceranic dhe Shkelzen Hajdini. Komisioni për Buxhet dhe Transfere është komision funksional i Kuvendit të Kosovës, fushëveprimtaria e të cilit është shqyrtimi i çështjeve që kanë të bëjnë me buxhet.

kërkuar që javën e ardhshme të ftohet për raportim ZRRE-ja. Këtë propozim e bëri deputeti i PDK-së, Memli Krasniqi, i cili tha se ZRRE-ja duhet të tregojë për përcaktimin e tarifave vjetore. “Mendoj se ZRRE-ja

është mirë të ftohet në takim që të na tregojë se si do të bëhet me tarifa. Mendoj se duhet të ftohet javën e ardhshme dhe ZRRE të tregojë për marrjen e hapave për përcaktimin e tarifave vjetore”, u shpreh Krasniqi.



Bahtiri takohet me shefin e ri të EULEX-it, flasin për sigurinë në Mitrovicë

MITROVICË, 25 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur në një takim shefin e ri të EULEX-it, Lars Gunnar Wigemark, me të cilin ka biseduar për zhvillimet aktuale dhe gjendjen e sigurisë në qytetin e Mitrovicës. Kryetari Bahtiri, pasi vlerësoi lart bashkëpunimin e komunës me zyrtarët e EULEX-it, e njoftoi shefin e EULEX-it, Gunnar Wigemark, për gjendjen aktuale politike e të sigurisë në Mitrovicë, për të cilën tha se është e qetë dhe pa probleme. "Së pari ju uroj punë të mbarë në postin tuaj të ri, duke ju



njoftuar se ne kemi pasur shkëlqyeshëm me pjesëtarët e çdoherë bashkëpunim të EULEX-it, andaj shpresoj që

raporte akoma më të mira do të kem edhe me ju, duke marrë parasysh se misioni juaj është shumë i rëndësishëm për shtetin tonë. Në komunën tonë janë bërë hapa të mëdhenj në stabilizimin e plotë të gjendjes së përgjithshme. Për këtë gjë u jam mirënjohës KFOR-it, Policisë së Kosovës, ambasadave dhe të gjithë ata që kontribuuan për ruajtjen e paqes për qytetin tonë", ka deklaruar Bahtiri.

Ndërkaq shefi i EULEX-it, Gunnar Wigemark, ka falënderuar për mirëpritjen dhe u shpreh të jetë i kënaqur me të arriturat e qytetit dhe punën e

kryetarit Bahtiri, duke shtuar se bashkëpunimi i mirë i deritanishëm ndërmjet komunës dhe EULEX-it vetëm sa do të rritet dhe të pasurohet edhe më shumë, me qëllimin e vetëm të realizimit të kërkesave të qytetarëve për të jetuar në paqe dhe siguri të plotë.

Në fund kryetari Bahtiri së bashku me shefin e EULEX-it, Gunnar Wigemark, u pajtuan të mbesin vazhdimisht në kontakt dhe të jetë i informuar lidhur me të gjitha ngjarjet në Komunën e Mitrovicës, në mënyrë që bashkërisht të kontribuojnë në ruajtjen e paqes dhe sigurisë së qytetit.

Restaurohet xhamia e vjetër e fshatit Shkozë të Malishevës

MALISHEVË, 25 SHKURT (ER) - Kanë përfunduar punimet restauruese - konservuese në mejtepin dhe xhaminë e vjetër të fshatit Shkozë të Malishevës. Këto punime janë drejtuar nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Prizren në kuadër të zbatimit të programeve për ndërhyrje në asetet e trashëgimisë kulturore të mbështetura financiarisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Xhamia dhe mejtepi i vjetër i fshatit Shkozë janë ndërtuar në vitin 1916. Sipas të dhënave gojore nga të moshuarit e këtij fshati, kjo xhami së bashku me mejtepin (shkollën) ishin ndërtuar me kontributin e fshatarëve mbi njëqind vjet më parë.

Në këtë xhami shkollë, përveç mësimave fetare, hoxhallarët patriotë qysh gjatë ish-Jugosllavisë mbretërore fshehtas

ua kishin mësuar fëmijëve shkrim-leximin në gjuhën shqipe përmes librave shqip që i kishin siguruar në fshehtësi nga konsulli i Shqipërisë së atëhershme në Shkup.

Objekti i xhamisë dhe mejtepit nga janari i vitit 1999, përveç si objekt i kultit, u shfrytëzua edhe nga kompania e UÇK-së e fshatit Shkozë si vendkomandë dhe vendstrehim i pjesëtarëve të saj. Forcat serbe, pasi thyen pozicionet e UÇK-së në mars të vitit 1999, e dogjën dhe e shkatërruan tërësisht këtë objekt.

Po sipas të dhënave të banorëve të këtij fshati, në këtë xhami shërbyen shumë personalitete të njohura të fshatit Shkozë, si hoxha i parë i fshatit Mulla Bajram Bytyçi, njëherësh edhe pleqnar dhe veprimtar i njohur i viteve 1900-1913, më pas shërbeu Hafës Islam Bytyçi, një hoxhë dhe intelektual i ri



atdhetar, poet dhe pjesëtar i organizatës së fshehtë atdhetare "Drita" që veprroi gjatë viteve 1930-1939. Gjithashtu, në këtë objekt fetar shërbeu edhe Mulla Adem Bytyçi, një hoxhë patriot i cili ishte udhëheqës i burrave të Shkozës dhe më gjerë në luftërat për mbrojtjen e kufirit të Shqipërisë etnike në Kollashin

gjatë viteve 1942-'44.

Drejtori i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Prizren, Samir Hoxha, ka theksuar se themelet e rrënojave të xhamisë së fshatit Shkozë, tashmë të restauruara, janë me rëndësi historike, por edhe e veçantë për arkitekturën lokale, ngaqë është ndërtesa e vetme arkitekturore

publike që ka pasur fshati Shkozë. "Veç të tjera, aty janë shkolluar gjenerata të tëra me njohuri fillestare. Pra, kjo ndërtesë ka ushqyer nevojën shpirtërore dhe arsimore të komunitetit dhe, si e tillë, ruajtja dhe prezantimi i këtij monumenti ishte i nevojshëm pasi që ajo paraqet burimin e dijes, në të njëjtën kohë dëshmon edhe për pasojat shkatërrimtare të luftës së fundit në trashëgiminë kulturore", ka thënë Hoxha.

Pas restaurimit dhe konservimit të themeleve të këtij aseti të trashëgimisë kulturore nga ana e Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Prizren, banorët e këtij fshati kanë shprehur gatishmërinë e tyre për t'u kujdesur për këtë monument, duke mos kursyer edhe mbështetjen financiare për rregullimin e ambientit rreth saj si dhe infrastrukturës përcjellëse.

Bashkëpunimi mes Komunës së Gjakovës dhe KFOR-it, i frytshëm

GJAKOVË, 25 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka pritur në takim kolonelin Natale Gatti, komandant i Komandës Rajonale - Perëndim të KFOR-it dhe i kontingjentit italian në Kosovë. Gjatë bashkëbisedimit, kryetari Gjini e informoi kolonelin Gatti për rrjedhën e përgjithshme të punëve që janë kryer në Gjakovë dhe projektet që janë në proces e sipër, për të cilat edhe është përgëzuar nga koloneli Gatte.

Ata thanë se bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Gjakovës



dhe KFOR-it italian ka qenë vazhdojë të jetë i tillë edhe më gjithmonë i frytshëm dhe do të tutje.



Në Lipjan mbillen fidanë të rinj

LIPJAN, 25 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, nëpërmjet disa fotografive të publikuara në llogarinë e vet në "Facebook", ka bërë me dije se të martën kanë bërë mbjelljen e fidanëve të rinj në ato vende ku ishin dëmtuar. "Nuk do të lejojmë që të dëmtohen, por do të vazhdojmë të kujdesemi për ambientin. Ambienti duhet të ruhet nga të gjithë. Dëmtimi i drunjve dekorativë është në dëm të shoqërisë, andaj duhet ruajtur dhe kujdesur nga të gjithë. Po ashtu, në qytet është duke u bërë kra-sitja e drunjve dekorativë që në pranverë të marrin pamje të bukur", ka shkruar kryetari Ahmeti.

Bashkëpunimi Shqipëri - Kosovë në arsim dhe shkencë është domosdoshmëri për integrimin ndërshqiptar



Nga prof. dr. Myqerem TAJ

Republika e Kosovës festoi javën e kaluar 12-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë. Sot, 20 vjet pas përfundimit të luftës dhe çlirimit të Kosovës nga zgjedha serb, si dhe 12 vjet pas shpalljes së Pavarësisë, është e rëndësishme të hedhim një vështrim se si është zhvilluar dhe deri ku ka arritur bashkëpunimi midis dy shteteve të të njëjtit komb, në fushën e arsimit dhe të shkencës, e cila duhet t'i paraprijë bashkëpunimit në çdo fushë tjetër ekonomiko-shoqërore.

Bashkëpunimi në fushën e arsimit, kulturës, shkencës, artit, sportit është përcaktues jo vetëm për ecurinë e bashkëpunimit në fusha të tjera, por edhe për gjithë procesin e integritit kombëtar. Në këtë kontekst, i gjithë procesi i bashkëpunimit midis dy vendeve duhet të konceptohet dhe ndërtohet në mënyrë që ai t'u krijojë hapësirë integrimi edhe shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Lugines së Preshevës, pra që ai të zhvillohet vërtet si bashkëpunim afatgjatë mbarëkombëtar, i cili i paraprin integritit ndërshqiptar në Ballkan. Ky proces do të kërkojë, ndoshta, shumë më tepër kohë nga sa e kemi menduar deri tani dhe do të vazhdojë edhe pas anëtarësimit të vendeve tona në BE. Këtu mjaftojmë ta kujtojmë përvojën e Gjermanisë 30 vjet pas bashkimit.

Marrëveshja ndërqeveritare e bashkëpunimit Shqipëri - Kosovë në fushën e arsimit dhe shkencës u nënshkrua në vitin 2010. Me anë të kësaj marrëveshje u shtua bashkëpunimi në fushën e kurrikulave si dhe u hartua, në vitin 2012, Abetarja e përbashkët, e cila vazhdon të përdoret në Shqipëri dhe Kosovë. Por ajo, edhe pse e anatamuar nga kjo qeveri, mbeti i vetmi tekst mësimor i përbashkët. Nuk u përvijua puna për hartimin e teksteve të tjera të përbashkëta në shkencat e identitetit tonë kombëtar. Sot duhet të ishin të përfunduar të paktën tekstet e përbashkëta të gjuhës shqipe, historisë së shqiptarëve, letërsisë shqipe. Por, fatkeqësisht, kjo nuk ka ndodhur ende. Është për t'u vlerësuar përafërsisht i kurrikulave në arsimin parauniversitar. Por, ne jemi ende larg në përafërsimin e kurrikulave të formimit universitar të mësuesve të rinj, përfshirë edhe provimin e shtetit. E them këtë sepse e shoh shumë të afërt ditën kur të dy vendet, sidomos në rajonet kufitare, do ta kenë të

domosdoshme që të rekrutojnë mësues të të dy vendeve. Ne duhet të përgatitemi për një treg të hapur punësimi të mësuesve të rinj, çka do të ishte me përfitime reciproke për të dy vendet dhe do të ishte një "rizgjim" i traditës së hershme, madje të fillimit të shekullit të kaluar, kur në shkollat e Shqipërisë punonin mësues nga Kosova dhe në shkollat e Kosovës punonin mësuesit normalistët e Elbasanit. Bashkëpunimi midis dy vendeve në arsim mbushet me jetë nga nxënësit dhe studentët. Duhet kërkuar dhe zhvilluar forma më realiste të shkëmbimit dhe mobilitetit të nxënësve dhe studentëve Shqipëri - Kosovë. Aktualisht kemi mobilitet më shumë njëkahësh të nxënësve dhe studentëve nga Kosova në Shqipëri dhe shumë më pak nga Shqipëria në Kosovë. Në këtë shekull, kur Procesi i Bolonjës synon që të paktën 1 në 5 studentë duhet të ketë ndjekur një semestër të studimeve në një nga universitetet e hapësirës evropiane të arsimit të lartë, na rezulton që ne nuk shkëmbejmë studentë midis universiteteve të Shqipërisë dhe Kosovës si dhe universiteteve të tjera shqipfolëse në Ballkan!

Gjendja e sotme tregon se nuk ka një përparim substancial të bashkëpunimit midis universiteteve dhe midis Akademive të Shkencave, edhe pse ka shumë marrëveshje në letër. Shkaqet janë të ndryshme. Por, sipas mendimit tim, shkaqet më të rëndësishme janë mungesa e politikave reale mbështetëse për bashkëpunim intensiv si dhe një prije paradoksale e "vetizolimit" e vet universiteteve shqiptare. Është e pabesueshme që, në fund të dekadës së dytë të shekullit të shoqërisë së dijes, universitetet të priren për t'u vetizoluar. Ky vetizolim nuk është pasojë vetëm e financimit të pamjaftueshëm, por edhe e mungesës së vizionit për internacionalizimin e universiteteve.

Është paradoksale që vitet e fundit po ulet çdo vit e më shumë shkëmbimi i pedagogëve midis dy vendeve, ndërkohë që edhe në vitet e regjimit të Titos ekzistonte shkëmbimi i profesorëve midis universiteteve të Shqipërisë dhe Universitetit të Prishtinës. Kjo traditë u zgjerua pas vitit 1990 dhe filloi të shtohet pas përfundimit të luftës së Kosovës. Universitetet e Shqipërisë kanë një kontribut shumë të rëndësishëm në zhvillimin akademik të universiteteve të Kosovës dhe të Universitetit të Tetovës jo vetëm në zhvillimin e programeve mësimore dhe të lëndëve, por edhe në udhëheqjen dhe promovimin e pedagogëve të tyre. Ky grup pedagogësh shërben akoma si urë lidhëse midis universiteteve. Shqipëria dhe Kosova nuk kanë asnjë pengesë për të krijuar një treg

të përbashkët të punësimit të pedagogëve dhe kërkuesve. Ende numërohen me gishtat e dorës profesorët nga Kosova në Shqipëri dhe e kundërta. Edhe ato pak raste iu përkasin shkollave të larta jo publike. Për të mos thënë që, në këtë aspekt, po vihet re regres! Madje janë ende të pakta rastet kur zhvillohen module nga grup pedagogësh nga të dy vendet, ndërkohë që edhe Procesi i Bolonjës synon mobilitetin e pedagogëve të vendeve të ndryshme në gjuhë të huaja! Kjo kërkon që universitetet dhe qendrat kërkimore të zhvillojnë politika më të hapura të rekrutimit të personelit akademik shkencor.

Sot duhet të kishim shumë diploma të përbashkëta të universiteteve të Shqipërisë dhe Kosovës, sidomos në nivelin Master dhe Doktoratë, fillimisht në shkencat shqiptare, pastaj edhe në shkencat e tjera. Madje ka një marrëveshje të nënshkruar që në vitin 2011 midis Universitetit të Tiranës dhe atij të Prishtinës për programe të përbashkëta të doktoratës në gjuhësi dhe histori. Por ato nuk po vazhdojnë. Do të ishte plotësisht realiste që, sot, pjesa më e madhe e programeve të doktoratës në universitetet shqipfolëse duhet të ishin të përbashkëta, doktorantët të udhëhiqeshin nga profesorë nga universitetet e ndryshme shqipfolëse dhe studimet e doktoraturës të realizoheshin një pjesë në Shqipëri dhe një pjesë në Kosovë. Kjo do të bënte që brezi i ri i pedagogëve, i cili do ta zhvillojë karrierën përgjatë 4-5 dekadave që vijnë, të ndihet pjesë e komunitetit akademik në Kosovë dhe në Shqipëri dhe kjo do të ishte garancia më e madhe e integritit ndërshqiptar, më së pari të vet komunitetit akademik. Për ta realizuar këtë nuk ka asnjë pengesë, përveç tendencës vetizoluese edhe në komunitetin akademik shqiptar.

Prija vetizoluese e universiteteve dhe institucioneve kërkimore shqiptare shfaqet edhe në kërkimin shkencor dhe veprimtarinë botuese. Vetëm dy veprimtari mbarëshqiptare zhvillohen rregullisht: seminari i Albanologjisë në Prishtinë dhe konferenca e Alb-Shkencës (kjo e fundit fatkeqësisht po shuhet me shpejtësi nga viti në vit!). Aktualisht nuk ekziston asnjë organ shkencor periodik i përbashkët, madje as në gjuhën shqipe, çka është e pabesueshme! Duket më i madh interesi për të botuar në gjuhën angleze dhe harrohen botimet në gjuhën shqipe, çka do të çojë në një varfërim të pakapërcyeshëm kulturor shqiptar. Çdo botim në shqip, pavarësisht nga fusha e shkencës, është një gurë, sado i vogël qoftë ai, në murin e kulturës kombëtare shqiptare. Ky zhvillim nuk i shërben zhvillimit dhe

integritit mbarëkombëtar.

Meqenëse shqiptarët në Ballkan janë vetëm rreth 8 milionë dhe të ndarë në pesë shtete, kjo bën që edhe komuniteti shkencor sipas fushave të jetë i vogël, madje në disa fusha shumë i vogël, çka bën që ne të mos arrijmë të kemi një "minimum të mjaftueshëm kritik" të komunitetit akademik për formimin e një mendimi shkencor shqiptar në fushën përkatëse, madje edhe në shkencat e identitetit kombëtar. Ne nuk aspirojmë të bëjmë shpikje në shkencë, por çdo komb e zhvillon mendimin e vet shkencor sipas fushave, në mënyrë që përmes tij t'i paraprijë edhe zhvillimit të gjithanshëm kombëtar. Ka fusha të shkencës ku të gjithë kërkuesit shkencorë të Shqipërisë, Kosovës dhe ata të gjithë trojeve shqiptare në Ballkan, të marrë së bashku, përbëjnë një komunitet shkencor shumë të vogël, me rreth 300-400 veta dhe po të punojë dhe të zhvillojë veprimtari shkencore i ndarë, ai e ka të vështirë të mbijetojë, pa folur për të zhvilluar një mendim shkencor sado modest qoftë ai.

Përvoja e vendeve të tjera tregon se shoqatat shkencore ku aderojnë kërkuesit nga vendet e ndryshme kanë pasur një kontribut përcaktues për zhvillimin e fushave të shkencës dhe të mendimit shkencor. Një shembull është modeli i shoqatave dhe fondacioneve gjermanishtfolëse, ku aderojnë dhe bëjnë jetën e tyre shkencore kërkues nga të gjithë vendet gjermanishtfolëse. Ose përvoja e Universitetit Nordik të përbashkët të Suedisë, Norvegjisë dhe Finlandës. Madje, Programi Erasmus Plus (Thirrja 2020) po nxit modelin e "European Universities", pra modelin e universitetit me bashkëveprim të disa universiteteve evropiane në fusha të përbashkëta. Ne ende diskutojmë për bashkëpunimin midis universiteteve të të njëjtit komb! Është e domosdoshme mbështetja dhe nxitja e krijimit të Shoqatave Mbarëkombëtare Shkencore sipas fushave, çka do realizonte një bashkim me efekte të mëdha sinergjike të kërkuesve nga të gjithë trojet shqiptare në Ballkan si dhe të Diasporës shkencore shqiptare. Këto shoqata, nëse do të ishin funksionale, do të rrezatonin efekte të jashtëzakonshme pozitive jo vetëm në zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës, por ato do të ishin edhe "Think Tank"-e ekselente shqiptare që do të kontribuonin në zhvillimin e strategjive afatgjatë dhe të rekomandimeve për politikën dhe politikbërjen e vendeve tona në çdo fushë si dhe për zhvillimin dhe prosperitetin e kombit shqiptar.

Shqipëria dhe Kosova nuk kanë asnjë pengesë për të krijuar

qendra të përbashkëta kërkimore, agjenci/fondacione të përbashkëta kërkimi, kurrikulash, madje edhe të cilësisë në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Kjo është më shumë çështje vizioni, strategjie e zhvillimit të arsimit dhe shkencës dhe e vullnetit politik të qeverive të të dy vendeve. Mbështetja financiare është e mundur thjesht përmes bashkimit të fondeve të të dy vendeve. Edhe në këtë plan ne thjesht po humbasim kohë! Ekzistojnë dhjetëra modele institucionale për krijimin dhe funksionimin e qendrave dhe institucioneve të përbashkëta të kërkimit shkencor. E para duhet të ishte Qendra Shqiptare e Studimeve Albanologjike, ku të bëhen studime albanologjike nga studiuesit e shkencave albanologjike të Shqipërisë dhe Kosovës, e hapur për të pritur edhe studiuesit shqiptarë nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Lugina e Preshevës. Kjo qendër duhet të bëhet edhe institucioni që do t'i presë albanologët e rinj të huaj, çka është shumë e rëndësishme kur po rritet presioni për bërthamat e albanologjisë në universitetet e huaja. Ne duhet të shkojmë në Akademinë e Shkencave të përbashkët. Qendra të tilla kombëtare ndërshqiptare mund të krijohen dora-dorës edhe në shkencat e tjera. Qendrat ndërshqiptare të kërkimeve do të kenë efekte sinergjike të jashtëzakonshme sepse bashkoin burimet njerëzore më të kualifikuara, infrastrukturën kërkimore, fondet dhe, mbi të gjitha, realizojnë një integrim të vërtetë të komunitetit akademik shkencor shqiptar, për të prodhuar cilësi shumë më të lartë të studimeve, kërkimeve dhe botimeve shqiptare në çdo fushë të shkencës. Sa më shumë të vonohemi në integrimin e komunitetit shkencor shqiptar aq më shumë kohë humbasim dhe aq më shumë e thellojmë prapambetjen në shkencë në krahasim me vendet e zhvilluara. Gjendja e bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Kosovës në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, librit, artit mishëron edhe nivelin e përgjithshëm të bashkëpunimit midis dy vendeve. Fatkeqësisht, klima e bashkëpunimit midis dy vendeve është vite dritë larg mundësive për dy vende fqinje dhe jo më për dy vende të të njëjtit komb, madje ajo është përkeqësuar aq shumë saqë ka arritur në nivelin më të ulët, së paku, të pas vitit 1990. Pasojat e marrëdhënieve kaq të përkeqësuar dëmtojnë jo vetëm rolin e shqiptarëve në Ballkan, por edhe vonojnë shumë zhvillimin e gjithanshëm të dy vendeve si dhe kontribuojnë në largimin akoma më të madh dhe nuk i shërbejnë integritit ndërshqiptar.

Konfirmohet rasti i parë me koronavirus në Kroaci

ZAGREB, 25 SHKURT - Në Kroaci është konfirmuar rasti i parë me sëmundjen e koronavirusit të ri. Këtë e bëri të ditur kryeministri Andrej Plenković, i cili saktësoi se i infektuari është një burrë i ri, gjendja e të cilit është stabile. Raportohet se ai është i shtruar në Klinikën e Sëmundjeve Infektive "Dr. Fran Mihaljević" në Zagreb. Ministri i Shëndetësisë i Kroacisë, Vili Berosh, tha se virusi u konfirmua te një per-

son që ka qenë në Milano të Italisë. "Sistemi shëndetësor është i gatshëm dhe ne po bëjmë gjithçka për sigurinë e kombit tonë. Nuk ka nevojë për panik, kjo sëmundje është si një grip i zakonshëm", ka thënë Berosh. Mbi 2 600 njerëz kanë vdekur në Kinë nga ky virus, që u paraqit për herë të parë në provincën kineze të Hubeit. Numri i rasteve të prekura në botë ka kaluar tashmë 80 000. Shenjat kryesore të infektim-

it me koronavirus janë temperatura e lartë, kollat dhe vështirësitë në frymëmarrje. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka thënë të hënën se bota duhet të bëjë më shumë për t'u përgatitur për pandemi të mundshme. OBSH-ja ka thënë se është ende herët që shpërthimi i koronavirusit të trajtohet si pandemi por, sipas saj, vendet "duhet të jenë në fazën e përgatitjeve".



Sandersi kritikohet për komentet mbi Kubën

WASHINGTON, 25 SHKURT - Kryesuesi i fushatës demokrate për president, Bernie Sanders, po përballet me kritika lidhur me komentet që bëri mbi ish-udhëheqësin e Kubës, Fidel Castro. Kandidati Sanders dhe rivalët kryesorë të tij brenda fushatës demokrate, përfshirë ish-zëvendës-presidentin Joe Biden dhe ish-kryebashkiakun e Nju Jorkut, Mike Bloomberg, janë në një garë intensive para zgjedhjeve paraprake mes demokratëve që zhvillohen të dielën në Karolinën e Jugut. Kjo cilësohet si prova e parë e madhe mes votuesve afrikano-



amerikanë. E marta që vjen, 3 marsi, e që njihet si super e marta, është një tjetër sfidë e madhe me votime në 14 shtete, që përbëjnë numrin më të madh të votuesve

deri tani. Fitorja e Sandersit të shtunën në Nevada, e cila erdhi pas paraqitjeve të mira në shtetet Ajova dhe Nju Hampshire, ka

shkaktuar shqetësim mes demokratëve të cilët e shohin senatorin, që e përshkruan veten si demokrat socialist, si tejet liberal për ta mundur presidentin Donald Trump në zgjedhjet e nëntorit. Sanders u përballet me kritika nga demokratët në Florida për komentet e tij lidhur me ish-udhëheqësin komunist Fidel Casto gjatë programit televiziv "60 minutash" që u transmetua të dielën. "Jemi shumë kundër natyrës autoritare të Kubës, por është e padrejtë të thuhet se gjithçka është e keqe", tha Sanders në intervistë ndërsa iu referua

Castros. "Kur Fidel Castro erdhi në pushtet, e dini si veçoi? Ai kishte një program masiv kundër analfabetizmit. A është kjo një gjë e keqe? Edhe pse e bëri Fidel Castro?" Citimet e Sandersit shkaktuan reagime nga demokratët e Floridës, një prej fushëbetëve të zgjedhjeve të përgjithshme dhe strehë e një popullsie të madhe të arratisurish nga Kuba gjatë regjimit të Castros. "Shpresoj që në të ardhmen zoti Sanders të gjejë kohë të flasë para elektoratit tim para se të vendosë të ngrrejë lart një tiran vrasës si Fidel Castro", u shpreh në "Twitter" ligjvënësja Donna Shalala.

Netanyahu i vendosur t'i vazhdojë ndërtimet në Bregun Perëndimor

JERUSALEM, 25 SHKURT - Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu tha të martën se do të vazhdojë planin për të ndërtuar rreth 3 500 shtëpi për kolonët hebrej në një nga zonat më të ndjeshme të Bregut Perëndimor. Plani ka hasur në vazhdimësi në kritika ndërkombëtare. Palestinezët, që e kundërshtojnë planin, kishin paralajmëruar se ndërtimet izraelite mund ta ndajnë Bregun Perëndimor, t'i largojnë

palestinezët nga Jerusalemi dhe t'i shuajnë më tej shpresat e tyre për një shtet palestinez. Rreth 500 000 hebrej jetojnë në rreth 140 vendbanime të ndërtuara që nga okupimi izraelit i Bregut Perëndimor dhe Jerusalemit Lindor. "Ndërtimet janë vonuar për gjashtë vjet e gjysmë", tha Netanyahu në një fjalim, gjashtë ditë para zgjedhjeve parlamentare. Netanyahu po kërkon mbështetje për rizgjedhje në postin e

kryeministrit. Palestinezët dhe pjesa më e madhe e botës i shohin vendbanimet e izraelit në Bregun Perëndimor, të okupuar në luftën e Lindjes së Mesme të vitit 1967, si të paligjshme sipas ligjit ndërkombëtar. Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli e kundërshtojnë këtë. Administrata e presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka thënë në fund të vitit 2019, se nuk i konsideron më



Pompeo thotë se Afganistani ka një mundësi historike për paqe



WASHINGTON, 25 SHKURT - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, tha se Afganistani ka një "mundësi historike për paqe", pasi Uashingtoni arriti një marrëveshje armëpushimi të përkohshme me talibanët. Duke

folur më 25 shkurt, Pompeo tha se nëse armëpushimi rezulton i suksesshëm, presidenti amerikan Donald Trump mund të jetë në gjendje të nënshkruajë një marrëveshje paqeje me talibanët "më ose rreth datës 29 shkurt" në mënyrë që të arrihet

fundi i luftës më të gjatë të Shteteve të Bashkuara. Në fillim të këtij muaji të dyja palët njoftuan një "ulje të dhunës" njëjavore që hyri në fuqi më 22 shkurt. Bisedimet mes një të dërguari amerikan dhe talibanëve janë zhvilluar që

nga viti 2018 në Katar. Por, arritja e një marrëveshjeje ka hasur në vazhdimësi në pengesa për shkak të sulmeve të talibanëve ndaj forcave afgane dhe atyre të huaja në Afganistan. Shtetet e Bashkuara kanë më shumë se 12 000 trupa në Afganistan.

Vdes ish-presidenti i Egjiptit, Hosni Mubarak

Kairo, 25 shkurt - Ish-presidenti i Egjiptit, Hosni Mubarak, ka vdekur në moshën 91-vjeçare, njoftoi televizioni shtetëror më 25

shkurt. Mubarak ka qenë në pushtet për gati tre dekada, para se të rrëzohej nga ushtria në shkurt të vitit 2011. Rrëzimit të tij nga pushteti i

paraprinë protesta në të gjithë vendin. Në qershor të vitit 2012 ai u shpall fajtor për bashkëpunim në vrasjen e protestuesve gjatë kryengrit-

jes popullore dhe u dënua me burgim të përjetshëm. Por, një gjykatë e lartë e shfuqizoi dënimin dhe Mubarak u la i lirë në mars të vitit 2017.



IRA dhe kerri i Petritit!

Daut DAUTI

Në fund të gushtit të vitit 1994, IRA shpalli armëpushim në luftën e saj të armatosur që kishte për qëllim përzënie e pushtetit britanik nga Irlanda Veriore. Armëpushimi u shpall pas 25 viteve të një fushate të ashpër të sulmeve me bomba, që kishte rezultuar me më shumë se 3000 njerëz të vdekur. Qeveria britanike e mirëpriti këtë akt dhe si reagim të parë e hoqi embargon për informim që ua kishte vënë anëtarëve të Sinn Fein-it, krahut politik të IRA-s (deri në këtë kohë televizionet dhe radiot britanike e kishin të ndaluar të emitonin zërin e aktivistëve të Sinn Fein-it). Armëpushimi ishte arsyeja për të shkruar për këtë temë dhe unë vendosa ta intervistoj Jerry



Viti 1994: Daut Dauti dhe Tom Hartley, që më vonë do të jetë kryetar i Belfastit

Adams-in ose Martin Mcguinness-in. Nga zyra e Sinn Fein-it, në telefon më thanë se këtë mund ta bëja kur të doja, por nuk dëshironin të më caktonin datë dhe kohë. E pyeta Petritin, një fotograf profesionist, nëse dëshironte të më shoqëronte për këtë punë. Ai u pajtua dhe me vete morëm edhe dy shokë tjerë, Maliqin dhe Tushin. Nga Londra udhëtuam me kerrin e Petritit, që ishte një Ford Granada ngjyrë qershie.

Kur mbërrimë në Belfast, shkova në Falls Road ku ishte selia e Sinn Fein-it në një ndërtesë çuditërisht të vjetër dhe të pa mirëmbajtur. Kur ju tregova pse kisha ardhur, dy gra më morën në pyetje duke shprehur shumë dyshime në stilin e policeve të ashpra. Përshtypja ime ishte se ato nuk kishin ide as çka është e as ku gjendet Kosova. Dikur e morën vesh pse isha aty, por më thanë që nuk kisha mundësi ta shihja Gerry Adams-in, pasi që ai kishte shkuar diku jashtë shtetit, e as Martin Mcguinness-in i cili gjendej i zënë me një aktivitet që zhvillohej në Derry, siç e quajnë katolikët republikanë Londonderry-in. Ju thashë që do

të prisja deri nesër ose pasnesër nëse ktheheshin.

Ndërkohë, ne e shfrytëzuam momentin për të vizituar Belfastin. U habita pse më parë nuk kisha dëgjuar që qyteti është i ndarë me një mur të madh që ndante katolikët me protestantët. Jo vetëm muri, por e tërë jeta ishte e ndarë në dy pjesë paralele. Afër murit qëndronin dy grupe të taksistëve: njëri për në pjesën katolike e tjetri për atë protestante. D.m.th. nuk përziheshin as taksistët e as udhëtarët. Gjithçka ishte e ndarë, përfshirë edhe pabiat dhe dyqanet. Në fakt ndarja në atë kohë në mes katolikëve dhe protestantëve ishte më e madhe se ajo në mes serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë. E pamë hotelin Europa, i cili pa dyshim e mbante epitetin e hotelit më të bombarduar në botë, pasi që



krahut politik të IRA-s dhe përgjegjës për shtyp. Pas disa viteve Hartley u zgjodh edhe kryetar i qytetit të Belfastit. Kjo ishte diçka nën nivelin e qëllimit tim, por megjithatë ishte më mirë se të kthehesha me duar të zbrazëta. Intervista u botua dhe unë isha i kënaqur që me siguri isha i pari që në mediat shqipe po shkruaja nga vendi i ngjarjes dhe po e përçoja idenë e IRA-së dhe gjasat për arritjen e paqes në Irlandën Veriore. Për mua kjo ishte një lloj historie.

Në fakt, histori shënoi kerri i Petritit. Pas dy viteve, në prill të 1996, Petriti vendosi ta shiste kerrin dhe e nxori lajmërimin në 'Loot', në gazetën e atëhershme që shërbente për shitblerje, dhe e caktoi çmimin 1200 funta. Menjëherë ishte lajmëruar një i interesuar. Kishte ardhur me një qese me 1000 funta, të gjitha nga 20 bankënota, dhe ia kishte lëshuar Petritit në dorë. 'Kaq mund të ofroj dhe nëse je i interesuar, merri paret dhe ma jep kerrin', i thotë ky njeriu i cili anglishten e fliste me theks të rëndë të një irlandezi. Petriti, duke e parë që kerri po vjetrohej, e pranon ofertën, por për çudi irlandezi nuk e nënshkruan kontratën e shitblerjes duke u arsyetuar se është analfabet. Pas tri javësh, derisa në Angli po zhvillohej kampionati evropian i futbollit, me 15 qershor në

Manchester eksplodoi një bombë e vendosur në kamion me 1500 kilogramë eksploziv. Bomba që vendosur nga 'Provisional IRA' që ishte një krah i IRA, i cili nuk pajtohej me armëpushimin e as me marrëveshjen për paqe që kishte filluar të iniciohej.

Ky ka qenë sulmi terrorist më i madhi që IRA ka bërë ndonjë herë në truallin britanik. Një bombë e madhësisë së tillë nuk

agjentë të shërbimit sekret britanik. 'Ku e ki kerrin?', ka qenë pyetja e parë për Petritin. Pas shumë pyetjeve tjera Petriti insiston që agjentët të tregojnë se ku qëndronte shkaku i 'vizitës' dhe kësaj 'interviste'. Pas disa pyetjeve tjera, agjentët i tregojnë Petritit se kerri i tij, Ford Granada, ngjyrë qershie, është përdorur në bombardimin e Manchesterit. Kerri, i cili kishte një lloj 'eksperience' irlandeze, ishte



Selia e dikurshme e Sinn Fein-it në Belfast

ka eksploduar në Britani të Madhe që nga sulmet e Gjermanisë fashiste gjatë Luftës së Dytë Botërore. Bomba e lajmëruar eksplodoi, pasi që ekipi i specialistëve britanik nuk pati mundësi ta neutralizonte. Pas disa ditësh, në derën e banesës së Petritit trokasin dy

përdorur si përcjellje e kamionit bombë dhe po ashtu edhe për evakuimin e 'shoferëve' të cilët e kishin 'parkuar' kamionin para qendrës tregtare. Terroristët kishin ikur me kerrin e Petritit, të cilin pastaj e kishin braktisur në Preston, një qytet afër Manchesterit. Agjentët pyesin nëse Petriti i kishte ende paratë apo qesen e najlonit nga ku mund të merreshin shenjat e gishtave. Kishte kaluar gati një muaj nga ngjarja dhe qesja ishte hedhur kurse paratë ishin dërguar në bankë.

Asnjë shenjë nuk kishte mbetur, pos kerrit të cilit, para braktisjes, i ishin fshirë të gjitha prekjet me duar.

Deri sot, pas 20 viteve, askush nuk ka asnjë informatë tjetër për këtë bombardim që shkaktoi aq shumë dëme: llogariten 200 veta të plagosur, kurse dëmi material ishte mbi 700 milionë funte.

Ka mbijetuar vetëm kerri i Petritit i cili ende mund të jetë diku në Polici për të shërbyer një ditë në gjyq si provë materiale kundër kryesve të këtij krimi. /Telegrafi/



Kerri i Petritit, Ford Granada ngjyrë qershie



©Valjet Rexhepi

MIMOZA KELMENDI NË BISEDË ME PROF. REXHEP QOSJEN

Gjuha letrare s'është çështje vetëm e gjuhëtarëve

Profesor, si do ta vlerësonit ju Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe dhe Gjuhën Letrare Shqipe të vitit 1972? Ju keni qene vëte i pranishëm në punimet e këtij kongresi. A pati ndikime të politikës aktuale për caktimin e bazës së formimit të gjuhës?

Rexhep Qosja: Formimi i gjuhës që e përdorin gjithë pjesëtarët e një kombi, për dallim prej gjuhës dialektore që e përdorin vetëm disa nga pjesëtarët e atij kombi, te secili popull ka shënuar shkallën më të lartë të zhvillimit e qytetërimit të tij. Nuk jemi përjashtim, apo jo? Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe dhe krijimi i Gjuhës Letrare shënon shkallën më të lartë në zhvillimin e qytetërimit tonë. Gjuha letrare është e arritura më e çmuar e procesit historik të zhvillimit të vetëdijës të popullit shqiptar, të kulturës, të letërsisë e të gjuhës së tij. Në këtë bisedë që po bëni ju me gjuhëtarë e shkrimtarë për Kongresin e Drejtshkrimit janë dëgjuar mendime pohuese

se ka pasur dhe mohuese se nuk ka pasur ndikime të tilla. Unë nuk mund ta di a ka pasur ndikim të politikës në përcaktimin e bazës së gjuhës letrare. Por, unë jam i bindur se ka pasur ndikime të udhëheqjes së shtetit shqiptar në mbajtjen e kongresit, e kjo d.m.th. edhe në formimin e Gjuhës Letrare Shqipe. Dhe kjo, për mendimin tim, është e kuptueshme. Do të ishte e pakuptueshme dhe, në një mënyrë, e panatyrshme, po të mos kishte pasur ndikim të tillë. Gjuha letrare s'është çështje vetëm e gjuhëtarëve, por është çështje e krejt një populli, e krejt një shoqërie. Një filozof gjerman e ka thënë se gjuha është fenomen aq i rëndësishëm sa që nuk guxojmë t'ua lëmë në duar vetëm gjuhëtarëve. Gjuha i bashkon, por gjuha edhe mund t'i ndajë njerëzit. Shteti është fryt i përpjekjeve bashkuese në historinë e një populi. Dhe, gjuha letrare standarde është fryt i përpjekjeve bashkuese në historinë e një populli. Nuk ka gjuhë letrare

atje ku nuk ka shtet, më saktësisht, atje ku nuk ka vetëdije për shtetin, për të përbashkëtën institucionale. Nuk është e rastit që gjuhët letrare kryesisht janë krijuar në kohët kur janë shtuar faktorët që vendosin lidhjet e përbashkëta në jetën e popujve: komunikacioni, administrata, qytetet e mëdha, universitetet, tregtia, librat, gazetatat e të tjera. Dhe, nuk është e rastit pse vetëdija për një gjuhë të përbashkët, për Gjuhë Letrare Kombëtare, te shqiptarët fillon në kohën e Rilindjes, domethënë në kohën kur shquhet lëvizja për pavarësi dhe për forimimin e shtetit shqiptar. E di se nuk ka shtet në këtë botë, së paku qe dy shekuj, që nuk ka këmbëngulur për një gjuhë letrare, sepse ashtu lehtësohet funksioni i shtetit dhe ashtu lehtësohet bashkimi i kombit. *Çfarë roli luajtën në atë kohë gjuhëtarët nga Kosova në vendosjen e kriterëve për Gjuhën Letrare Shqipe? A ka pasur argumente se kjo gjuhë është imponuar për të hequr dorë nga*

gegërishtja?

Rexhep Qosja: Të gjitha punët, gjuhësore, administrative, politike, për mbajtjen e Kongresit të Drejtshkrimit janë bërë në Tiranë, natyrisht. Gjuhëtarët nga Kosova nuk kanë mundur të luajnë farë roli të drejtpërdrejtë në vendosjen e kriterëve për gjuhën letrare, sepse komunikimet me Shqipërinë ishin shumë të penguara prej pushtetit jugosllav. Por, gjuhëtarët nga Kosova, megjithatë, në masë të madhe e kanë nxitur, e kanë frymëzuar, e kanë ndihmuar vendosjen e atyre kriterëve, së pari me Konsultën e Prishtinës, mbajtur në vitin 1968, e pastaj me përkrahjen e deklaruar të të gjithë intelektualëve kosovarë për krijimin e gjuhës letrare mbi kriteret që ishin shpallur. Atëherë nuk është dëgjuar zë kundër gjuhës letrare. Përkundrazi. Është dëgjuar përkrahje me entuziazëm të jashtëzakonshëm. Ne, për fat, nuk kemi menduar për gjuhën prej aspektit të dialektit. Ne kemi menduar për gjuhën

letrare si pjesëtarë të një kombi, ashtu më në fund siç duhej të mendojmë edhe sot.

Ka zëra që gjuha letrare për 50 vjet nuk u familjarizua nga shqiptarët në Kosovë. Kjo, sipas tyre, ka sjellur dygjuhësinë. Si mendoni ju, sa është e vërtetë kjo tezë?

Rexhep Qosja: Sipas mendimit tim – kjo është tezë e rrejshme. Tek të gjithë popujt që kanë gjuhët letrare sot, përpos gjuhës standarde, në të folur, më pak a më shumë, përdoren edhe dialektet vendore. Duke u përgatitur për këtë bisedë me ju – unë lexova në librin e gjuhëtarit të njohur Oto Jespersen, "Njerëzimi i popullit dhe individi nga aspekti linguistik" se gjuha e gjermanëve të arsimuar, edhe sot, pak a shumë, pas aq shumë vitesh të krijimit të gjuhës letrare, është gjuhë dialektalisht e ngjyrosur. Dhe, nuk thuhet se gjuha standarde gjermane nuk është familjarizuar në Gjermani, Austri a në ndonjërin krahinë gjermane.

Çdokush që do t'i dëgjojë fëmijët dhe të rinjtë e Kosovës, në shkolla, fakultete, vendtubime të ndryshme, se sa lehtë, se sa natyrshëm e flasin Gjuhën Letrare Shqipe, do të bindet se sa mirë është familjarizuar ajo në Kosovë.

Sa janë të përgjegjshëm vetë gjuhëtarët në Kosovë, por edhe shtresa intelektuale në përgjithësi, në njësimin e Gjuhës Letrare Shqipe, si një gjuhë e vetme dhe e standardizuar?

Rexhep Qosja: Numri më i madh i gjuhëtarëve dhe klasa intelektuale pothuajse në përgjithësi, me ndonjë përjashtim të rrallë, e përkrahin Gjuhën Letrare Kombëtare si gjuhë e vetme e standardizuar. Dhe, këtë e bëjnë me shumë përkushtim, e bëjnë me shumë përgjegjësi. Jam i bindur.

Ju jeni shkrimtar dhe autor i një sërë veprash letrare. Sa kanë ndikuar shkrimtarët kosovarë në pasurimin e gjuhës shqipe?

Rexhep Qosja: Besoj se kanë ndihmuar ndjeshëm, qoftë duke ia sjellë gjuhës letrare leksikonin e viseve ku kanë lindur, qoftë duke trajtuar përmbajtje të reja, në trajta të reja moderne letrare që kërkojnë shprehje më të përbërë figurative e simbolike që doemos e pasuron gjuhën letrare në përgjithësi.

Sot, profesor, janë një sërë mediash në gjuhën shqipe në Kosovë. A ndikojnë pozitivisht ato dhe auditori shkollor në Kosovë në përvetësimin e masës për përdorimin e një gjuhe të tillë?

Rexhep Qosja: Mësuesit, arsimtarët e profesorët në Kosovë kanë bërë shumë dhe vazhdojnë të bëjnë shumë për përdorimin e gjuhës së përbashkët. Ata mund të quhen ajo shtresa profesionale së cilës ia detyrojnë ngritjen e kulturës gjuhësore të të rinjve të Kosovës. Edhe mediat kanë ushtuar dhe ushtrojnë ndikim pozitiv në ngulitjen e normës letrare gjuhësore. Për fat të keq, në media, natyrisht me pak përjashtime, gjuha është shumë e thjeshtësuar, e kthyer gjithnjë e më dukshëm në gjuhë zhargonit, në të cilën si edhe në politikë, zotërojnë disa fjalë, si për shembull fjalët: liria, pavarësia, demokracia, republika, që s'kanë lidhje me përmbajtjen kuptimore dhe me kontekstin që do t'i shpjegonte ato. Këtu kemi një paradoks të çuditshëm. Mediat e ndihmojnë përdorimin e gjuhës letrare me vetë faktin se e përdorin. Por, e ndihmojnë duke e varfëruar jashtëzakonisht shumë. Ngjet kështu sepse përmbajtja mbizotëruese e medieve tona janë politika, së cilës ato shumë përlushëm i shërbejnë, dhe argëtimi. Ngjet kështu sepse mediat, në mënyrë të veçantë mediat elektronike, tregojnë një disponim të vazhdueshëm

kundërintelektual, sigurisht në ndikimin e disa faktorëve që inteligjencinë vazhdojnë ta quajnë si në kohën e komunizimit, prodhuese të nacionalizmit.

Me pretendimin se gegërishtja është gjuhë shqipe dhe jo serbe, çfarë mendimi keni ju, ose cili është vlerësimi juaj se kujt i shërben përdorimi i saj sot dhe a duhet për disa sektorë të vendosen ligje në përdorimin e Gjuhës Letrare Shqipe?

Rexhep Qosja: Në një shoqëri demokratike çdokush mund ta flasë a ta shkruajë gjuhën që do, gjuhën letrare apo dialektin. Është çështje tjetër, ndërkaq, ne qoftë se dikush e mohon gjuhën e përbashkët letrare për hir të dialektit apo në qoftë se dikush e mohon gjuhën letrare kombëtare në emrin e dy të ashtuquajtuarve gjuhë dialektore letrare. Në një rast të tillë kemi të bëjmë me çështje serioze, jo gjuhësore, por, në radhë të parë, me çështje politike. Në Kosovë dhe në Shqipëri mund të dëgjohen individë që e mohojnë gjuhën e përbashkët dhe

predikojnë veçimin dialektor. Ata janë të frymëzuar prej qarqesh politike në Prishtinë që përvjedhin idenë sipas së cilës Kosova karshi Shqipërisë duhet të zhvillohet si Austria karshi Gjermanisë dhe harrojnë se Gjermania dhe Austria, megjithatë, kanë një gjuhë letrare, Gjuhën Letrare Gjermane. Ata janë të frymëzuar, ma merr mendja, njëkohësisht edhe prej qarqesh të huaja politike që tradicionalisht janë përpjekur t'i ngatërojnë punët e shqiptarëve. Të gjitha, thotë Gëte, janë të vdekshme, vetëm marrëzirat janë të pavdekshme. Përpjekjet për rrënimin e gjuhës letrare mund të bëhen edhe ndonjë ditë, por janë të dështuara sepse janë prapakthime kundërhistorike që do të kishin pasoja shumë të mëdha.

Sa i përket pjesës së dytë të pyetjes suaj se a duhet të vendosen ligje në disa sektorë në përdorimin e gjuhës, unë mund të them më sa vijon: përdorimi i gjuhës letrare është i rregulluar jo vetëm me marrëveshje, por edhe me ligje në vendet që kanë


gjuhë të standardizuar, në administratë, arsim, shëndetësi, ushtri, në institucionet e shkencës e kulturës, në media, mund të përdoret vetëm gjuha e standardizuar. Kështu është edhe të ne, por në disa vende rregullimi i çështjeve të gjuhës letrare është çuar edhe më përpara. Në disa vende në ministritë e arsimit e të kulturës e në disa akademi të shkencave bëjnë kujdesin për kulturën e gjuhës në përgjithësi. Këto institucione caktojnë, fjala vjen, se cilat fjalë të huaja mund të përdoren në gjuhën standarde. Në Slloveni, për shembull, ekziston gjyqi i gjuhësisë që dënon shkeljet e normave të gjuhës letrare.

Profesor, çfarë do të thotë për ju si shkrimtar një shkrim i shkruar në gjuhë letrare dhe çfarë do të thotë një shkrim i shkruar në gegërisht?

Rexhep Qosja: Të shkruash në gjuhën letrare, sipas mendimit tim, së pari do të thotë të shkruash si njeri me kërkesa më të larta shpirtërore, kurse të shkruash në dialekt do të thotë

të shkruash me kërkesa sado kudo me të rrudhura shpirtërore. Të shkruash në gjuhën letrare do të thotë të shkruash me mundësi më të mëdha të shprehjes gjuhësore e dialekte do të thotë të shkruash me mundësi më të pakta të shprehjes gjuhësore e artistike. Të shkruash në gjuhën letrare do të thotë të shkruash për shumë më tepër lexues, për gjithë pjesëtarët e popullit të cilit i takon, kurse të shkruash në dialekt do të thotë të shkruash për më pak lexues, për pjesëtarët e atij dialekti. Të shkruash në dialekt do të thotë të vjtërohesh gjuhësisht më shpejt, kurse të shkruash në gjuhën e njësuar letrare do të thotë të shkruash për kohë shumë më të gjatë, në mos jo përgjithmonë. Ata që duan ta dënojnë vetën e të shkruajnë për më pak lexues e për kohë më të shkurtër duhet t'i përkujtojmë për këtë, por në asnjë mënyrë t'i pengojmë. Njeriu duhet të jetë i lirë të bëjë ç'të dojë me veten e tij.

(Marre nga libri "Shansi gjerman dhe shqiptarët")





INTERVISTË ME GEORGE STEINER-in

Çdo filozofi është një akt gjuhe, çdo mendim fillon nga një poezi

Francus George Steiner ishte një kritik letrar Franko-Amerikan, eseist, filozof, novelist dhe edukator, (politikbërës i arsimit). Ai ka shkruar gjërësisht për ndërvarjen midis gjuhësisë, letërsisë dhe shoqërisë, si dhe ndikimin e Holokaustit. Një artikull në gazetën "Guardian" e përshkruan Steiner si "poliglot dhe polimat".

Europa po përjeton një krizë të thellë. Sipas mendimit tuaj, a është e mundur shembja e saj?

Në gjendjen e saj të sotme, është e mundur. Por kemi për t'ia dalë mbanë njëfarësoj. Ironia është që Gjermania do mund të mbizotëronte përsëri. Le të sprapsimi pak në kohë. Mes muajit gusht 1914 dhe muajit maj 1945, Europa, nga Madridi në Moskë, nga Kopenhaga në Palermo, humbi pothuajse 80 million qenie njerëzore në luftat, internimet, kampet e vdekjes, zitë e bukës, bombardimet. Mrekullia është se ajo ka mbijetuar. Por ringjallja e saj ka qenë e pjesshme. Europa sot po kalon një krizë dramatike ; ajo është duke sakrifikuar një brez, brezin e ri, i cili nuk beson në të ardhmen. Kur isha i ri kishte lloj-lloj shpresash : komunizmi, e çfarë shprese ! Fashizmi, që është gjithashtu një shpresë, nuk duhet të gabohesh. Ekzistonte, po ashtu, për çifutët, sionizmi. E plot, e plot... Të gjitha këto nuk i kemi më. Mirëpo në rini, po nuk u mbajte nga një



shpresë, qoftë kjo edhe e gënjeshtërt, çfarë mbetet ? Asgjë. Ëndrra e madhe mesianike socialiste përfundoi me gulagun dhe François Hollande-in – e marr emrin e tij si simbol, nuk kritikoj personin e tij. Fashizmi u zhyt në tmerr. Shteti izraelit, domosdoshmërisht që duhet të mbijetojë, por nacionalizmi i tij është një tragjedi, thellësisht i kundërt me gjeninë çifute, që është kozmopolite. Unë vetë dua që të jem një endacak. Jetoj sipas devizës të Baal Shem Tov-it, rabin i madh i shekullit XVIII : « *E vërteta është gjithmonë në mërgim.* »

Po globalizmi a e favorizon këtë endje ?

Nuk ka patur asnjëherë një mbyllje të tillë gjeografike. Kur linim

Anglinë, mund të shkonim në Australi, në Indi, në Kanada ; sot nuk ka më të drejtë pune. Planeti po mbyllet. Çdo natë qindra vetë përpiqen të hyjnë në Europë nga Magrebi. Planeti është në lëvizje, po drejt çfarë gjëje ? I tmerrshëm është sot fati i emigrantëve. Në Gjermani më nderuan me një fjalim që mbajta përpara qeverisë. E mbylla me këto fjalë : « Zonja e Zotërinj, tani gjithë yjet po bëhen të verdhë. »

A ndiheni european pavarësisht këtyre ?

Europa mbetet vendi i masakrës, i pakuptueshmërisë, por edhe i kulturave që dua. I detyrohem për gjithçka dhe dua të jem aty ku janë të vdekurit e mi. Dua të qëndroj pranë Holokaustit, atje ku

mund të flas katër gjuhët e mia. Kjo është qetësia e madhe, lumturia, kënaqësia ime. E kam mësuar italishten pas anglishtes, frëngjishtes e gjermanishtes, tri gjuhët e fëmijërisë. Nëna ime fillonte një frazë në një gjuhë dhe, pa e vënë re, e përfundonte në një tjetër. Nuk kam patur gjuhë amtare dhe, përkundër klisheve, kjo gjë është mjaft e zakonshme. Në Suedi kemi finlandishten dhe suedishten ; në Malajzi fliten tri gjuhë. Ideja e gjuhës amtare është një ide tepër nacionaliste e romantike. Njohja e disa gjuhëve më ka mundësuar të jap mësim, të shkruaj librin *Après Babel : une poétique du dire et de la traduction* dhe të ndihem gjithkund si në shtëpinë time. Çdo gjuhë është një dritare e hapur mbi botën. Pemët kanë rrënjë ; ndërsa unë, unë kam këmbë, dhe ky është një progres i jashtëzakonshëm, më besoni !

Në librin tuaj të fundit *Poezi e mendimit*, ju tregoni që Sartridonte të ishte Stendal dhe Spinoza. A të shpie stili tek mendimi ?

Po, çdo filozofi është një akt gjuhe. Ritmi, fjalori, sintaksa, gjithçka që na shpie drejt poezisë, e gjejmë edhe në tekstin filozofik, sado abstrakt qoftë ai. « *Çdo mendim fillon nga një poezi* », shkruante Alain në lidhje me Valéry-në. Mendimtarët e mëdhenj shpeshherë janë edhe

shkrimtarë të mëdhenj, siç është rasti i Nietzsche-s apo Kierkegaard-it.

Bergson-i, një nga mjeshtrat e gjuhës frënge, është fitues i çmimit Nobel në letërsi. Platoni meriton të krahasohet me Shekspirin përse i përket krijimit të personazheve e gjeveve dramatike. Por marrëdhënia midis mendimit dhe shkrimit mund të shfaqet edhe konfliktuale. Disa filozofë shkruajnë keq, e mbytin shkrimtarin që kanë brenda vetes, si Hegeli, mbreti i anti-stilit. Këtë traditë dyfishtë të gjenisë lirike te Platoni dhe atë të pedagogjisë së rreptë, sistemit, tek Aristoteli, e gjejmë që në fillim.

Letërsia dhe filozofia a janë akoma bashkëpunëtore sot ?

Të dyja këto forma më duken të rrezikuara. Letërsia ka zgjedhur fushën e marrëdhënive të vogla vetjake. Ajo nuk di më t'u qaset temave të mëdha metafizike. Nuk kemi më Balzac, apo Zola. Asnjë lëmë nuk u shpëtonte këtyre gjenive të komedisë njerëzore. Edhe Proust-i ka krijuar një botë të pashtershme, ndërsa *Ulliksi* i Joyce-it është ende shumë pranë Homerit... Joyce është nyja mes dy botëve, asaj klasike dhe asaj të kaosit. Dikur, edhe filozofia mund ta quante veten universale. E gjithë bota ishte e hapur ndaj mendimit të Spinozës.

Sot, një pjesë e madhe e universit na është mbyllur. Bota jonë po

tkurret. Shkencat na janë bërë të pakapshme. Kush mund t'i kuptojë aventurat e fundit të gjenetikës, astrofizikës, biologjisë? Kush mund t'ia shpjegojë ato profanit? Dijet nuk komunikojnë më; shkrintarët dhe filozofët janë të pazotë për të na e bërë të kuptueshme shkencën. E megjithatë shkencë shkelqen nëpërmjet imagjinatës së saj. Si mund të pretendosh që të flasësh për ndërgjegjësim njerëzor duke lënë mënjanë atë çka është më e guximshme, më imagjinative? Shqetësohem kur mundohem të kuptoj se çdo të thotë « të jesh i ditur » sot – « to be literate », shprehja është më e fortë në anglisht. A mund të jemi të ditur pa kuptuar një ekuacion jo linear? Kultura po rrezikon të bëhet provinciale. Ndoshta do të na duhet ta rimendojmë krejt konceptimin që kemi për kulturën.

Dua t'ju tregoj një rast që më ka emocionuar pa masë: një mbrëmje, një nga kolegët e mi të Kembrixhit, çmim Nobel, një burrë i këndshëm me të cilin po darkoja, më kërkoi ta ndihmoja me një tekst të Lakanit nga i cili nuk kuptonte asgjë. Ja modestia e një shkencëtari të madh krahasuar me fodullëkun e zotave bizantinë të errësirës...

Ju mbroni kulturën klasike të njeriut të kulturuar dhe në të njëjtën kohë këmbëngulni në brishtësinë e saj. Përse?

Sepse kultura e lartë ka falimentuar përballë barbarisë. Të mos harrojmë që të dyja luftrat botërore ishin luftra civile europiane. Gjermania, vendi i Hegelit, Fihthes dhe Shelingut, matricë e

mendimit filozofik, ka njohur barbarinë më të keqe. Humanitetet nuk na kanë mbrojtur; përkundrazi, shpesh ato kanë qenë aleatë të çnjerëzores. Bukenvaldi ndodhej veçse disa kilometra larg prej Weimarit. Si ka mundësi që disa njerëz të luajnë Bah e Shubert në shtëpinë e tyre në mbrëmje dhe të nesërmen në mëngjes të torturojnë nëpër kampe?

Për çfarë shërben kultura atëhere, në qoftë se nuk na bën më njerëzorë?

Ajo e bën të durueshme ekzistencën. Nuk është e lehtë të jesh i vdekshëm, jo, nuk është aspak e lehtë. Të gjithë përballemi me kancerin, stresin, frikën; çdo ditë mund të mbartë një lamtumirë dhe s'ka gjë më të ankthshme se kjo. Do t'ju tregoj diçka me të vërtetë foshnjore: unë dhe gruaja humbëm qenin tonë Ben. Ishte e tmerrshme për ne, aq shumë kjo kafshë ka qenë në qendër të jetës sonë – madje aq sa doli edhe në kopertinën e Cahier de l'Herne që më përkushtuan mua!

Nuk mund të kaloj një ditë pa muzikë, pa bukuri, pa poezi. Kjo është siguria ime, mbijetesa ime. Shoqëria e mjeshtërvë të mëdhenj më jep një ndjenjë të pafund krenarie e mirënjohjeje. Dua t'u them falemnderit. Duke i mësuar përmendsh. Atë që mësojmë përmendsh askush nuk mund të na e heqë. As censura, as policia politike, as kitsch-i që na rrethon. Të mësuarit përmendsh do të thotë të futesh në brendësi të veprës: « *Ti do jetosh brenda meje dhe unë do jetoj me ty.* »

Tekstet ecin përbri nesh; të shëtisësh me një poezi të Baudelaire-it do të thotë që të

jesh i mirëshoqëruar.

Sipas jush, teknologjitë e reja e rrezikojnë « qetësinë » dhe « intimitetin », që janë dy gjëra të domosdoshme për kontaktin me veprat e mëdha...

Po, cilësia e qetësisë është organikisht e lidhur me atë të gjuhës. Ju dhe unë jemi të ulur këtu, në këtë shtëpi të rrethuar nga një kopsht, ku nuk ka tjetër zhurmë përveç bisedës sonë. Këtu mund të punoj, të ëndërroj, të përpiqem për të menduar. Qetësia është bërë një luks i madh. Njerëzit jetojnë në zallamahi. Nuk ka më natë në qytete. Të rinjtë kanë frikë nga qetësia. Ç'është bërë me leximin serioz e të vështirë? Të lexosh një faqe nga Platoni me walkman në vesh? Kjo më tremb shumë.

Teknologjitë e reja transformojnë dialogun me librin. Ato shkurtojnë, thjeshtëzojnë, konektojnë. Mendja është « e kablluar ». Sot nuk lexohet si dikur. Fenomeni *Harry Potter* shfaqet si përjashtim. Të gjithë fëmijët e globit, fëmijë eskimezë, fëmijë zulu, lexojnë e rilexojnë këtë sagë ultra angleze të pajisur me një fjalor të pasur dhe me një sintaksë të sofistikuar. Kjo është e hatashme! Libri është një mbrojtës i madh i jetës private. Në frëngjisht nuk ka fjalë për të thënë fjalën « privacy ». « Intimitet » e përkthen keq atë. Anglia është akoma një vend i « privacy-së ». Kjo mund të ketë edhe anët e saj absurde: mund të jemi fqinjë për pesëdhjetë vjet e të mos shkëmbejmë një fjalë. Ky kult i « private life » ka një vlerë të madhe politike: është një aftësi qëndrese.

Ju përmendët Harry Potter. Duke u kthyer tek *Poezi e mendimit*, ju guxoni që të bëni një lidhje mes dialektikës së Hegelit, mohimit të mohimit, dhe shprehjes « rien de rien » të Edith Piaf-it. Përse kultura popullore nuk ju ka interesuar më shumë?

I kam rënë së mirës me shkëlqim. Sidomos me kinemanë. Sikur të mund të rifilloja jetën, do të mundohesha të kuptoja përse, mes forcave krijuese të fundshekullit XIX dhe fillimshkullit XX, filmi do duhej ndoshta të kalonte në vend të parë. Shekspiri, sot, do kishte shkruar skenarë. Aq shumë kam qenë fëmijë i gjuhës greke e latine dhe i një babai ultrakonservator klasik, sa që kam gabuar. Nuk mund të jemi të përditësuar me gjithçka. Me muzikën, po: dëgjoj kompozitorë të kohës pas Boulez-it e që më pasionojnë. Me artin konceptual, jo, nuk arrij ta ndjek: shkoj në Beaubourg, më tregojnë një piring me tulla duke më thënë që kjo është një vepër e rëndësishme, nuk di çfarë të them; i ndërkohë që e kuptoj Bacon-in kur citon Velazquesz-in, Greco-n e Goya-n. Më mirë që të jesh i ndershëm me gabimet e tua, sesa të bësh bluf.

Po ju, a e konsideroni veten si krijues?

Jo, nuk duhen ngatërruar funksionet. Edhe vetë kritiku, komentuesi, ekzegjeti më i talentuar është disa vite dritë larg krijesit. Pushkini thoshte: « *Falemnderit përkthyes, falemnderit botues, falemnderit kritik, ju mbartni shkrimet e mia, por jam unë ai që i shkruaj ato.* » Edhe unë mbart letrat. Ky është një privilegj shumë i madh, por kjo nuk ka të bëjë fare me mrekullinë e një vargu që do të

recitohet gjithmonë. I kuptojmë keq burimet intime të krijimit. Ja një shembull, jemi në Bernë para shumë vitesh... Fëmijët nisen për piknik me mësuesen e tyre, e cila i vendos ata përpara një viadukti. Ata vizatojnë, mësuesja vështron mbi supin e një fëmije; ai u ka veshur çizme kolonave! Që prej asaj dite gjithë viaduktët ecin. Ky fëmijë quhej Paul Klee. Krijimi ndryshon gjithçka që vëzhgojmë; një krijuesi i mjaftojnë vetëm disa vija për të na bërë të shohim atë që ishte tashmë aty. Çfarë mister i çliron krijimi? Kam shkruar librin *Gramatika të krijimit* pikërisht për të kuptuar këtë mister. Tani, në fund të jetës, vazhdoj të mos e kuptoj.

Mos vetë të kuptuarit na largon nga arti?

Në njëfarë kuptimi, jam i lumtur që nuk kuptoj. Imagjinoni një botë ku neurokimia do na shpjegonte Mozart-in...

Po kjo është e mundshme dhe më tremb. Makineritë janë tashmë interaktive me trurin: kompjuteri dhe specia njerëzore punojnë bashkë. Ndoshta një ditë mund të ndodhë që historianët të kuptojnë se ngjarja më e rëndësishme në shekullin XX nuk ishte lufta, as kriza financiare, por ajo natë kur shahistin Kasparovin e mundi një kuti e vogël prej metali. Dhe shkroi « *Makineria nuk përlogariti, por mendoi.* » Kur e pashë këtë, kërkova mendimin e kolegëve të mi në Kembrixh që janë mbretërit e shkencës. Më thanë që nuk e dinin nëse mendimi nuk është përlogariti. Kjo është një përgjigje e tmerrshme! A do mundet që kutia e vogël një ditë të kompozojë muzikë? /Mapo.al/

Përktheu Ylli DEMNERI



E rrallë

Furrtari libanez që tash e 13 vjet u jep ushqim të freskët të pastrehëve

Një furrtar me zemër të madhe tash e 13 vjet ushqen të pastrehët. Chris Mansour, pronar i furrës One Way Lebanese në Melbourne të Australisë, filloi me punën e tij bamirëse, pasi pa dy persona duke kërkuar ushqim nëpër kontejnerë të mbeturinave para lokalit të tij. I prekur nga ajo që pa, vendosi t'i



ndihmojë. Çdo pasdite ai mbushë kutitë me baklava, ëmbëlsira dhe specialitete të tjera të cilat ua jep të pastrehëve.

FOTO E DITES



Një punëtor me veshje mbrojtëse grumbullon kova plastike që përmbajnë mbeturina mjekësore nga pacientët e infektuar me koronavirus. /AP/

E jashtëzakonshme

Qeni hyn në rajonin e policisë për ta shpallur veten të humbur

Një qen në Teksas eci rreth 1.5 kilometra larg shtëpisë në mes të natës dhe përfundoi në Departamentin e Policisë. Policët e Departamentit të Policisë në Odessa të ShBA-së u shokuan kur një qen hyri brenda godinës, shkruan "Daily Mail". Ai u largua nga shtëpia gjatë kohës që pronari i tij ishte duke fjetur. Rreshteri Rusty Martin tha: "Ne



të gjithë ishim të ngazëllyer që e morëm atë brenda ndërtesës. Kemi pasur një top tenisi dhe ia hodhëm që të luante. Të gjithë e donim shumë. Ne menduam se ai dëshironte të aplikonte për një pozicion pune pranë nesh", ka shkruar në "Facebook" policia Odessa.

BARSOLETA E DITËS

Dy shoqe:
 - Sa isha për pushime në Turqi e kam blerë një peshore për t'u matur.
 - Dhe halli?
 - Sa herë po hip në të po ma qet "Mashallah".

KINO ABC PRISTINE

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00
Spies in Disguise 3D
 I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno

Në ora 18:00
Jumanji; The Next Level 3D
 Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

Regjia: Jake Kasdan

Çdo natë në ora 20:00
STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D
 Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

Regjia: J.J. Abrams

Çdo natë në ora 22:30
THE GRUDGE
 Horror/Mister; 1 orë 34 min


Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Të lindurit e kësaj shenje ka gjasa të ndihen të irrituar gjatë ditës së sotme. Ndoshta kjo mund të ndodhë për shkak të gjendjes financiare.</p>	 <p>DEMI Ekziston mundësia të gaboni teksa bëni disa përlogaritje. Si rezultat i kësaj mund të gaboni gjatë një plani financiar.</p>	 <p>BINJAKËT Mos u tregoni të ashpër kur debatoni vetëm për ta mbrojtur idenë tuaj. Madje kjo mund të ndikojë negativisht edhe në gjendjen tuaj psikologjike.</p>	 <p>GAFORRJA Nuk rekomandohet të ndjeni keqardhje për të kaluarën apo të kritikoni veten. Mendoni për të tjera gjëra, që janë më të rëndësishme për ju.</p>	 <p>LUANI Ekziston mundësia të gaboni teksta bëni disa përlogaritje. Si rezultat i kësaj mund të gaboni gjatë një plani financiar.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Nuk parashikohen probleme këtë të martë për të lindurit e kësaj shenje. Megjithatë, kjo ditë parashikohet të jetë monotone.</p>
 <p>PESHORJA Ekziston mundësia të bëni një sjellje që do t'i habitë të tjerët. Bëni kujdes, pasi mund të ndikojë në përhapjen e thashethemeve për ju.</p>	 <p>AKREPI Mund të realizoni çdo objektiv tuajin nëse veproni me vendosmërinë. Një i afërm apo një mik mund t'ju ofrojë mbështetje maksimale.</p>	 <p>SHIGJETARI Asgjë nuk do t'ju bëjë përshtypje sot. Do të veproni ashtu sikur dëshironi, pa u menduar dy herë. Beqarët e kësaj shenje rekomandohen të mos tregohen të nxitur.</p>	 <p>BRICJAPI Të lindurit e kësaj shenje do të marrin shumë këshilla të vlefshme sot. Nëse ndërprisni dikë teksa po përpiqet t'ju mësojë, do të ofendohej shumë.</p>	 <p>UJORI Kjo e martë do të karakterizohet si një ditë mjaft e ngjeshur. Bëni gjithçka që mundeni për ta ruajtur qetësinë.</p>	 <p>PESHQIT Kjo ditë premtan të jetë e qetë. Duhet t'u kushtoni vëmendje të veçantë çështjeve profesionale dhe planifikimit financiar. Bëni mirë ta analizoni rrethin e miqve të vjetër.</p>

Justin Bieber me albumin e ri thyen rekordin e Elvis Presleyt



Pas më shumë se gjysmë dekadë këngëtari Justin Bieber ka tejkaluar rekordin e mbajtur nga legjenda Elvis Presley. Albumi i shtatë i Justin Bieberit, 'Changes', ka debutuar në krye të tabelës 'Billboard të ShBA-së', duke mposhtur një rekord të vendosur nga Elvis Presley 59 vjet më parë. Këngëtari kanadez tani është artisti më i ri që

në moshën 25-vjeçare ka arritur të renditet i pari në 'USA Chart' me shtatë albume. Elvis ishte 26 vjeç kur shënoi këtë sukses, me 'Blue Hawaii' më 1961. 'Changes', që është albumi i parë i Bieberit në katër vjet, arriti një numër prej 231 000 kopjesh të shitura javën e kaluar. Ajo, gjithashtu, kryesoi tabelën në Mbretërinë e Bashkuar.

Kirk Douglas dhuron pasurinë prej 61 milionë dollarësh për bamirësi dhe nuk i lë asgjë djalit Michael



Gjatë jetës së tij Kirk Douglas gjithmonë ka financuar shoqata bamirëse. Pothuajse 20 ditë nga vdekja, tabloidi "Mirror" zbulon se aktori i famshëm amerikan ka dhuruar të gjithë pasurinë e tij për bamirësi, pa i lënë asgjë djalit Michael dhe nipërve. Një pasuri prej 61 milionë dollarësh. Ylli që vdiq më

5 shkurt në moshën 103-vjeçare kishte një pasuri prej 61 milionë dollarësh. Pjesa më e madhe e trashëgimisë (rreth 51 milionë dollarë) janë destinuar për Fondacionin Douglas, i krijuar shumë vite më parë nga vetë Kirk dhe nga bashkëshortja e tij Anne për t'i ndihmuar personat e vetmuar dhe në vështirësi.



Billie Eilish s'ka të ndalur, vazhdojnë sukseset me këngën e James Bondit

"No Time To Die" nga Billie Eilish është shndërruar në këngën e dytë të serisë së filmave James Bond, e cila kryeson tabelën e hiteve single në Mbretërinë e Bashkuar. Këtë sukses më parë e kishte arritur Sam Smith me "Writing's On The Wall" për James

Bond: Specter në vitin 2015. Eilish, e cila u bë 18-vjeçare në dhjetor, është artistja më e re që ka regjistruar një këngë për ekskluzivitetin e filmave Bond. Ylli performoi "No Time to Die" live për herë të parë këtë javë, në Brit Awards në Londër.

Koronavirus, ndërpriten xhirimet në Venezia të 'Mission Impossible 7' me Tom Cruise



Xhirimet e filmit të fundit të serive 'Mission Impossible' me Tom Cruise janë ndërprerë në Itali për shkak të shpërthimit të epidemisë së koronavirusit. Mediat amerikane shkruajnë se

pjesa e shtatë e serive të Paramount Picture kishte në program për të bërë disa xhirime në Venezia për tri javë, por për shkak të shpërthimit të epidemisë është shtyrë për momentin.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Më 2 mars dalin në shitje online biletat për ndeshjen Maqedoni e Veriut - Kosovë

PRISHTINË, 25 SHKURT - Biletat për gjysmëfinalen e plejofit të Ligës së Kombeve në futboll në mes të Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës do të dalin në shitje online më 2 mars, kanë njoftuar mediat e Maqedonisë së Veriut të martën.

Ndeshja në mes të Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës do të luhet në stadiumin "Todor Proevski" në Shkup dhe është gjysmëfinale e plejofit të Ligës D të Ligës së

Kombeve. Shitja online e biletave do të bëhet nëpërmjet platformës "MK Tickets".

Njoftohet se një person do të ketë të drejtën e blerjes të vetëm një bilete me letërnjoftim apo pasaportë.

Do të bëhet shitja e biletave për tribunën jugore dhe veriore nëpërmjet sistemit online dhe do të kushtojnë pesë dhe gjashtë euro.

Federata e Futbollit të

Maqedonisë së Veriut ka vendosur që një numër i konsiderueshëm i biletave të ndahet edhe në Lidhjet Komunale të Futbollit, ndërsa tribuna perëndimore e stadiumit do të jetë e rezervuar për tifozët e Maqedonisë së Veriut, ndërsa ajo lindore për të Kosovës.

Ndeshja Maqedoni e Veriut - Kosovë luhet më 26 mars me fillim nga ora 20:45.



De Biasi tregon pse nuk e mori Rashicën në Evropian

PRISHTINË, 25 SHKURT - Njeriu që arriti ta dërgonte Shqipërinë në Evropian si trajner, Gianni De Biasi, ka qenë i ftuar në "Procesin Sportiv". Aty ka bërë një rrëfim të gjatë, ndërsa ka njoftuar se do ta ketë akademinë e tij edhe në Durrës, atje ku do të stërviten fëmijët e vegjël. Kur është pyetur në lidhje me mungesën e Rashicës në Evropian dhe që nuk shkoi te Shqipëria, përgjigja ka qenë ironike. "Më intereson ta kuptoj këtë rilindjen e Tiranës. Dua të shoh nëse është një projekt teknik apo rastësor. Ta merrja Partizanin? Kur u largova nga Kombëtarja shkova në Spanjë dhe po synoj një tjetër lloj niveli. Erdha në Shqipëri pasi në

verën e ardhshme kam ndërmend të hap diçka në Durrës, një akademi në Tropikal, atje ku stërvitja Kombëtare. Ndihej vërtet shumë mirë duke bërë këtë punë, megjithëse nuk mund të them që më jep të njëjtën kënaqësi si atëherë me Shqipërinë. Do të jetë një kamp sportiv dhe fëmijët duhet të jenë pjesë e saj. Nga moshën 6-16 vjeç mund të jenë pjesë që ta marrin formimin e duhur. Rashica? Duke qenë se nuk donim të fitonim Evropianin, e lamë Rashicën në shtëpi sepse nuk donim ta fitonim. Atëherë ishte shumë i vogël dhe nuk ishte ky fenomeni që shikoni sot në Bundesligë", ka thënë De Biasi.



Shtatorja e Majlinda Kelmendit përurohet të premten në Pejë

PEJË, 25 SHKURT (ER) - Shtatorja e heroinës sonë, kampionesa olimpike Majlinda Kelmendi, do të përurohet të premten (28 shkurt) në vendlindjen e saj në Pejë. Përrurimin e shtatores do ta bëjë presidenti i Federatës Ndërkombëtare të Xhudos, Marius Vizer, i cili do të jetë i

pranishëm edhe në ceremoninë e Laureatëve 2019, të organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës më 27 shkurt. Majlinda është sportistja e vetme e Kosovës me medalje Olimpike. Ajo fitoi të artën në kategorinë -52 kg të xhudos në Lojërat Olimpike RIO 2016.

ORARI I NDESHJEVE TË IPKO SUPERLIGËS DHE LIGËS SË PARË

PRISHTINË, 25 SHKURT (ER) - Është caktuar orari i ndeshjeve të javës së 20 në Ipko Superligë dhe të javës së 19 në Ligën e Parë. Edhe java e 20 në elitë nis të premten, kur do të zhvillohen dy ndeshje, kurse tri ndeshje do të luhen të shtunën dhe një ndeshje të dielën.

E premte, 28 shkurt
13.00 Drita-Drenica
13.00 Ferizaj-Llapi

E shtunë, 29 shkurt
13.00 Feronikeli-Trepça '89
13.00 Dukagjini-Gjilani
17.00 Prishtina-Ballkani

E diel, 1 mars
13.00 Flamurtari-Vushtrria

Liga e Parë - java 18

E shtunë, 29 shkurt në orën 13.00
Istogu-Drenasi
Vitia-Malisheva

E diel, 1 mars në orën 13.00
Vllaznia-KEK-u
Trepça-Onix
Arbëria-2 Korriku
Liria-Ulpiana
Vëllaznimi-Ramiz Sadiku
Dardana-Besa



Mourinho e kërkon yllin e Chelseat në Tottenham

Trajneri i Tottenhamit, Jose Mourinho, është duke insistuar në transferimin e futbollistit brazilian të Chelseat, Willian, shkruan "Daily Star" të martën.

Tottenhami pritet të bëjë ofertë për Willianin 31-vjeçar. Willian ka kontratë me Chelsean deri në verë dhe bisedimet për vazhdim të kontratës me Chelsean kanë

stagnuar në javët e fundit. Willian është lojtar i rëndësishëm i Chelseat. Sulmuesi anësor këtë stinor ka luajtur 33 ndeshje në të gjitha garat, ndër-

sa ka shënuar pesë gola e asistuar pesë herë. Willian te Chelsea gjendet që nga vera e vitit 2013 kur u transferua nga Anzhi për 35 milionë euro.





Michael Jordani shpërthen në lot në ceremoninë përkujtimore për Kobe Bryantin

Michael Jordani nuk ka mundur t'i mbajë lotët në momentin që mori fjalën për ta kujtuar Kobe Bryantin dhe vajzën e tij në ceremoninë përkujtimore.

Legjenda e basketbollit ka thënë se ai gjithmonë kishte dashur të jetë vëllai i madh më i mirë që mund ta kishte ish-ylli i LA Lakersit, por aksidenti me helikopter i ndau. "Dua të falënderoj Vanessan dhe familjen Bryant për mundësinë që ma dhanë që ta mbaj fjalimin për Kobin dhe Giannan. Ndoshta disa persona mund të befasohen, por unë dhe Kobe ishim shumë të afërt, ishim vëllezër. Kemi ndarë të gjitha gjërat. Gjithmonë kam dashur të jem

vëllai i tij i madh, vëllai më i mirë që ai ka pasur. Kemi shkëmbyer shumë gjëra mes vete, nuk kemi shikuar asgjë mes vete. Komunikuam në orë të mëngjesit, madje kur unë apo ai ishim duke fjetur. Nëse ju e doni dikë, duhet të shkoni deri në gjëra ekstreme dhe të bëni gjithçka për të edhe nëse duhet ta rrezikoni jetën tuaj. Kobe ishte inspirim për mua", ka shtuar më tej Jordan.

Legjenda e basketbollit ndërroi jetë në moshën 41-vjeçare derisa po udhëtonte me helikopter së bashku me vajzën e tij 13-vjeçare dhe shtatë njerëz të tjerë për një ndeshje basketbolli në fillim të këtij viti.



Pele 'kërcënohet' nga Messi, argjentinasi është 17 gola larg rekordit të legjendës braziliane

Pele "kërcënohet" nga Messi, argjentinasi është 17 gola larg rekordit të legjendës braziliane. Nuk kanë qenë të pakta rastet kur specialistë të futbollit mundohen të bëjnë krahasime mes Messit dhe Ronaldos, që janë lojtarët më të mirë të momentit dhe Maradonës dhe Pele, që janë dy nga futbollistët më të mirë të së shkuarës. Mbase nuk mund ta ndash dot

me thikë pasi janë futbollistë që kanë luajtur në periudha të ndryshme, kanë stile të ndryshme loje dhe sigurisht se me kalimin e viteve edhe futbollit ka evoluar dhe nuk është më njësoj si më parë.

Por, ama mund të bëjmë një krahasim me shifrat. Statistikat thonë se Lionel Messi është 17 gola larg legjendës braziliane, Pele sa iu takon golave të real-

izuar me një klub të vetëm. Pele ka shënuar 643 gola në 656 ndeshje gjatë 19 sezoneve që ka luajtur me Santosin, ndërsa sulmuesi i Barcelonës ka realizuar 626 në 715 ndeshje.

Shifra vërtet të frikshme të argjentinasi, por Messi ka mundësinë që ta barazojë dhe tejkalojë rekordin e Peles brenda këtij sezoni, pasi ka akoma shumë ndeshje për t'u luajtur.

Liverpooli mund ta shesë Mohamed Salahun për 150 milionë euro

Jamie Carragher ka thënë se Liverpooli mund ta shesë Mohamed Salahun nëse pranon një ofertë të majme. Legjenda e The Reds beson se një shumë prej 150 milionë eurove do të bënte që ylli egjiptian të largohej nga Anfield Road. "Nuk ka asnjë shans që ata të shesin Alisson Beckerin apo Virgil Van Dijkun", ka thënë fillimisht ai. "Por, nëse dikush ofron 150

milione euro për kartonin e Mohamd Salah, mendoj se Liverpooli do ta kishte në konsideratë. Për këtë them se ai është i paparashikueshëm. Është një rast më ndryshe se i Alisson apo i Van Dijk", ka shtuar tej Carragher. Real Madridi thuhet se është i interesuar për transferimin e Salahut, mirëpo mbaë një shikim nga afër edhe te Sadio Mane.





K O N K U R S

Pozita e punës: Zyrtar/e Ligjor (1 pozitë).

Kohëzgjatja e kontratës: 1 vit, me mundësi vazhdimi.

Orari i punës: I plotë.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen punë ligjore për ndërmarrjen;
- Asiston në përpilimin e rregulloreve dhe akteve tjera të ndërmarrjes;
- Me kërkesë të udhëheqësit përgatitë vendime, shkresa, parashtrësia për ndërmarrjen;
- Me kërkesë të udhëheqësit, harton kontrata, marrëveshje dhe memorandume për nevoja të ndërmarrjes;
- Ndhmon sekretarin në ofrimin e këshillave ligjore dhe bën hulumtime ligjore për nevoja të ndërmarrjes;
- Kujdeset për përgatitjen, shtypjen e materialeve të mbledhjeve dhe shpërndarjen e tyre.
- Mban procesverbalin e mbledhjeve të menaxhmentit dhe komiteteve të tjera në rast nevoje.
- Monitoron dhe koordinon punët e Burimeve Njerëzore;
- Bën rregullimin e dosjeve dhe mban regjistrin e tyre.
- Kryen edhe detyra tjera të caktuara nga udhëheqësi.
- Kryen edhe detyra dhe obligime të parapara me akte normative të brendshme.
- Për kryerje e detyrave dhe përgjegjësi i përgjigjet Sekretari/Menaxheri i Zyrës Ligjore të ndërmarrjes.

Përgatitja profesionale

- Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik, niveli Bachelor apo Master;
- Përvoja e punës përparësi;
- Aftësi shumë të mira të punës me kompjuter;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Etik profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion;

Dokumentacioni i kërkuar:

Kandidati, duhet t'i dorëzoj këto dokumente në formë të skanuar në email: punesimi@trafikurban-pr.com;

1. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;
2. Dëshmi mbi shkollimi;
3. Dëshmi mbi përvojën e punës (nëse posedon);
4. Kopja e letërnjoftimit;

-Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në s'kualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes e-mailit: punesimi@trafikurban-pr.com.

Konkursi është i hapur nga data **26.02.2020** dhe përfundon më datë **11.03.2020** në ora 24:00.



K O N K U R S

Pozita e punës: Zyrtar për IT (Teknologji Informativ) -1 pozitë;

Kohëzgjatja e kontratës: 1 vite, me mundësi vazhdimi;

Orari i punës: Orar jo i plotë i punës (Gjysmë orari).

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ofrimi i shërbimeve dhe menaxhimi i pajisjeve të teknologjisë së informacionit për të krijuar një sistem funksional në përputhje me nevojat dhe kërkesat e ndërmarrjes
- Përgatitja e kërkesave të shfrytëzuesve dhe specifikacioneve tjera teknike;
- Kujdeset për montimin e pajisjeve të teknologjisë informativë përfshirë kompjuter, printer, skaner dhe pajisje tjera;
- Ndhmon personelin e ndërmarrjes në përdorimin e pajisjeve të teknologjisë informativë, aplikacioneve dhe bazave të dhënave dhe kryen aktivitete tjera me qëllim për t'iu ofruar gjithë personelit qasje të lehtë në sistemin e teknologjisë informativë;
- Instalon kompjuterët me sisteme operative Windows, Office dhe softuer tjetër sipas nevojës duke u kujdesur për ruajtjen e shënimeve;
- Ndhmon në rregullimin dhe monitorimin e masave përforcuese të programeve softuerike dhe shërbimet ndihmëse.
- Për punën e tij/saj i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

Përgatitja profesionale:

-Shkolla e mesme apo Diplomë Universitare - Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe Teknologji Informativë;
-Përvojë punë profesionale 3 vite;

Shkathtësitë të tjera:

- Mirëmbajtje të kamerave;
- Help desk support;
- Mirëmbajtje e printerëve;
- Njohuri të shkëlqyera me Windows 7 dhe 10;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit.
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale.
- Njohuri të mira të programeve kompjuterike;

Dokumentacioni i kërkuar:

Kandidati/ja, duhet t'i dorëzoj këto dokumente në formë të skanuar në email: punesimi@trafikurban-pr.com;

1. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;
2. Dëshmi mbi shkollimi;
3. Kopja e letërnjoftimit;
4. Certifikata tjera (përparësi).
5. Dëshmi mbi përvojës së punës;

-Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit: punesimi@trafikurban-pr.com
Konkursi është i hapur nga data **26.02.2020** dhe përfundon më datë **11.03.2020** në ora 24:00

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara dhe të pa nënshkruara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se shoqëria » ALBSTAR « SH.P.K., me seli në PRIZREN, BULEVARDI I RINISË P.N., ka marrë vendim që ta shuaj Shoqërinë me NRB. dhe NRF. 811300730 me likuidim vullnetar dhe e ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e prodecurës së likuidimit vullnetar.

I njoftojmë të gjithë klientët që kanë raporte kreditore-debitore me këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditësh nga data e shpalljes së likuidimit vullnetarë në gazetë.

OBAVEŠTENJE

Obaveštavamo sve kliente da društvo » ALBSTAR « D.o.o., sa sedištem u PRIZREN, BULEVARDI I RINISË P.N. doneo je odluku o gašenju biznisa sa REG.Br. i FBR. 811300730 putem dobrovolne likuidacije i ujedno imenovao likuidatora o vodjenju postupka dobrovoljne likuidacije.

Obaveštavaju se svi klienti koji imaju potraživanja i obaveze u navedenom društvu, da se jave u roku od 30 dana od dana oglašavanja dobrovoljne likuidacije u novini.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that the company » ALBSTAR « L.L.C., based in PRIZREN, BULEVARDI I RINISË P.N., has taken the decision to cancel the company with Busines and Fiscal No. 811300730 and with voluntary liquidation and has appointed a liquidator for the development of voluntary liquidation proceeds.

We notify all clients that have credit - debit reports with this company to appear within 30 days from the date of announcement of voluntary liquidation in the newspaper.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se shoqëria » NCO GROUP « SH.P.K., me seli në PRIZREN, WILLIAM WALKER P.N., ka marrë vendim që ta shuaj Shoqërinë me NRB. dhe NRF. 81285990 me likuidim vullnetar dhe e ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e prodecurës së likuidimit vullnetar.

I njoftojmë të gjithë klientët që kanë raporte kreditore-debitore me këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditësh nga data e shpalljes së likuidimit vullnetarë në gazetë.

OBAVEŠTENJE

Obaveštavamo sve kliente da društvo » NCO GROUP « D.o.o., sa sedištem u PRIZREN, WILLIAM WALKER P.N. doneo je odluku o gašenju biznisa sa REG.Br. i FBR. 81285990 putem dobrovolne likuidacije i ujedno imenovao likuidatora o vodjenju postupka dobrovoljne likuidacije.

Obaveštavaju se svi klienti koji imaju potraživanja i obaveze u navedenom društvu, da se jave u roku od 30 dana od dana oglašavanja dobrovoljne likuidacije u novini.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that the company » NCO GROUP « L.L.C., based in PRIZREN, WILLIAM WALKER P.N., has taken the decision to cancel the company with Busines and Fiscal No. 81285990 and with voluntary liquidation and has appointed a liquidator for the development of voluntary liquidation proceeds.

We notify all clients that have credit - debit reports with this company to appear within 30 days from the date of announcement of voluntary liquidation in the newspaper.

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj kujdestare për vajzën 7 muajshe në Prishtinë.
Për informata në tel: 044-444-009

▶ Selami Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.

▶ Auto Andi SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811299511

▶ N.P. "Graniti" shpall të pavlefshme certifikatën e regjistrimit me numër fiskal: 60103506.

▶ Bekim Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Lirija" Bellacerk

▶ Isuf Jashari shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

▶ Erkan Velija shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

▶ Vilard Maloku shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Matilo Goreci" Prizren

▶ Gjemile Sope shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Dëshmorët e Zhurit" Zhur

▶ Majlinda Bajramaj shpalle të pavlefshme diplomën e bachelorit të Fakultetit Juridik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokal me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/giejpuneshpejte



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues